



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 356 Akti**

**Nr. 428 Vendimi  
Tiranë, më 29.7.2021**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

**Brunilda Bekteshi**  
**Pamela Qirko**  
**Suela Zhegu**

**Kryesuese**  
**Relatore**  
**Anëtare**

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Ertugena Sokoli, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në Tiranë, më 27 korrik 2021, ora 14:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Ken Dhima**, me funksion gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr.76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;  
**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;  
**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;  
**Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”;

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Pamela Qirko, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura prej tij gjatë hetimit administrativ, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

## VËREN:

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në nenin 179/b, paragrafi 5 i ligjit nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe, në nenin 3, pika 5 dhe nenin 5, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Subjekti i rivlerësimit, z. Ken Dhima, me funksionin gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, është subjekt që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
3. Bazuar në nenin 14, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, pas zhvillimit të procedurave të shpërndarjes së çështjeve me short në datën 12.11.2019, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Ken Dhima, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 3, i përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Alma Faskaj dhe Brunilda Bektoshi. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioneri Pamela Qirko.
4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 2.12.2019 u caktua me mirëkuptim kryesuese Brunilda Bektoshi, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Ken Dhima. Me e-mailin e datës 18.1.2020, subjekti i rivlerësimit deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupit gjykues.
5. Bazuar në pikën 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, z. Ken Dhima, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.
6. Me vendimin nr. \*\*\*, datë 9.3.2020, Komisioni vendosi rishpërndarjen me short të çështjeve të vitit 2018 dhe 2019 të komisionerit, znj. Alma Faskaj, për shkak të mungesës për shkaqe objektive. Pas shpërndarjes me short<sup>1</sup>, anëtar zëvendësues në çështjen e subjektit Ken Dhima rezultoi komisioneri Suela Zhegu, e cila deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit.
7. Procesi i vlerësimit të pasurisë, në përputhje me kreun IV të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.
8. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.
9. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.
10. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe

---

<sup>1</sup> Vendimi i Komisionit nr. \*\*\*, datë 9.3.2020 (protokolluar me nr. \*\*\*, datë 9.3.2020), “Për rishpërndarjen me short dhe transferimin e çështjeve të komisionerit znj. Alma Faskaj, me cilësinë e anëtarit të trupit gjykues të caktuara me procedurat e shortit të muajit shtator, nëntor 2018 dhe janar, mars dhe nëntor 2019”.

Konfliktit të Interesave (këtu e në vijim “ILDKPKI”); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (këtu e në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (këtu e në vijim “KLGJ”).

**11. ILDKPKI-ja**, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti është konstatuar se:

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- ka kryer fshehje të pasurisë;
- ka kryer deklarim të rremë dhe;
- nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

**12. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)** ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin e mbajtur për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

**13. Këshilli i Lartë Gjyqësor** ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

**14. Në vijim**, janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara nga pika 5 e nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

**15. Trupi gjykues**, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vlerësoi se ato arrijnë nivelin e provueshmërisë dhe, në datën 9.7.2021 vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht, bazuar vetëm në kriterin e pasurisë për subjektin e rivlerësimit, z. Ken Dhima; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t’u njohur me materialet e dosjes në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35-40, 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

**16. Po në datën 9.7.2021**, subjektit të rivlerësimit iu komunikuan rezultatet e hetimit administrativ dhe analiza financiare e kryer nga Komisioni, si dhe u njoftua mbi të drejtën për të paraqitur pretendime/shpjegime apo të kërkonte depozitim të provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, duke i caktuar afatin 14-ditor për marrjen e aksesit në dosjen e rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit nuk ushtroi të drejtën për t’u njohur me aktet e dosjes dhe as nuk paraqiti parashtrime dhe/apo prova të reja lidhur me rezultatet e hetimit administrativ.

**17. Në këto kushte**, pas përfundimit të afatit të mësipërm, trupi gjykues, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

**18. Subjekti i rivlerësimit** u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, me e-mail, në datën 26.7.2021. Me e-mailin e datës 27.7.2021, ora 9:57, subjekti i rivlerësimit ka njoftuar se nuk do paraqitet në seancën dëgjimore të datës 27.7.2021, ora 14:00.

**19.** Gjithashtu, subjekti ka depozituar në protokollin e Komisionit një raport mjekësor<sup>2</sup>, i cili përcakton 3 ditë pushim, nga data 27.7.2021 dhe aftësinë për punë në datën 30.7.2021.

**19.1.** Komisioni vëren se në e-mailin e dërguar, subjekti ka njoftuar se nuk mund të paraqitet në seancë, por nuk ka kërkuar shtyrjen e saj për shkak të pamundësisë për t'u paraqitur.

**19.2.** Trupi gjykues, me qëllim shmangien e zvarritjes së procesit të rivlerësimit, si edhe në kushtet kur subjekti mund të shfrytëzonte të drejtën e caktimit të një përfaqësuesi ligjor, sipas parashikimeve të bëra në nenin 70 e vijues të Kodit Civil, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi<sup>3</sup> mosshyrjen e seancës dëgjimore për subjektin e rivlerësimit, z. Ken Dhima, por zhvillimin e saj në datën 27.7.2021, ora 14:00, sipas njoftimit të bërë.

**20.** Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit, z. Ken Dhima u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më 27.7.2021, ora 14:00, në ambientet e Pallatit e Koncerteve (ish- Pallati Kongreseve), salla B, kati 0, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs. Subjekti i rivlerësimit nuk u paraqit në seancën dëgjimore dhe as nuk ushtroi të drejtën e përfaqësimit.

**21.** Në përfundim të relatimit të rezultateve të hetimit kryesisht, trupi gjykues njoftoi se seanca për shpalljen e vendimit do të mbahej në datën 29.7.2021.

### **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

**22.** Z. Ken Dhima nuk ka qenë gjithmonë bashkëpunues gjatë procesit të rivlerësimit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, duke mos iu përgjigjur drejtpërdrejt të gjitha pyetjeve të dërguara gjatë hetimit administrativ, si edhe duke mos depozituar dokumentacionin e kërkuar nga Komisioni, si gjatë hetimit administrativ, ashtu edhe me dërgimin e rezultateve të hetimit.

### **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI**

**23.** Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

**24.** Ligji nr. 84/2016 ka përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, si dhe të proporcionalitetit, parime këto, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor. Në këtë ligj përcaktohet angazhimi i organeve kompetente ndihmëse në procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni.

**25.** Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

**26.** Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

**27.** Sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse për kryerjen e vlerësimit profesional.

<sup>2</sup> Raporti mjekësor me nr. regjistri \*\*\*, nr. serial \*\*\*, i dorëzuar nga shtetasi K.Xh, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 27.7.2021.

<sup>3</sup> Vendim i ndërmjetëm nr. \*\*\*, datë 27.7.2021.

**28.** Por, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017<sup>4</sup> dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

**29.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja bashkë me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, “Vetting”, deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite si dhe aktet mbështetëse si dokumentacion bashkëlidhur raportit; b) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; c) raportin e kontrollit të figurës, të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; ç) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja; d) denoncimet e publikut; e) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit, si dhe nëpërmjet postës elektronike për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit

## **A. VLERËSIMI I PASURISË**

**30.** Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti dhe ligjshmërisë së burimit dhe të krijimit të saj.

**30.1.** Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting”, të paraqitur më parë në ILDKPKI, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion, i cili pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit.

**30.2.** Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, si edhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive. Në deklaratën “Vetting” (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI më 23.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar këto pasuri (të luajtshme dhe të paluajtshme):

**31. Apartament,** me sipërfaqe 114.6 m<sup>2</sup>, ndodhur në Tiranë, rruga “\*\*\*”, hyrja \*\*\*, apartamenti \*\*\*, me vlerë 74,000 euro, porositur me kontratën e shitjes me rezervë, datë 3.6.2005, finalizuar blerja me kontratën e shitjes së datës 7.4.2015. Subjekti ka deklaruar se zotëron 50% pjesë takuese të kësaj pasurie.

**31.1. Si burim krijimi** ka deklaruar: (i) të ardhurat nga paga si student i Shkollës së Magjistraturës; (ii) të ardhurat nga paga e bashkëshortes, K.Ç, si studente e Shkollës së Magjistraturës; (iii) të ardhurat nga paga si gjyqtar; (iv) të ardhurat nga paga e bashkëshortes si gjyqtare; (v) kredinë e marrë në “Tirana Bank” me kontratën e datës 22.7.2005, në shumën prej 52,000 euro; (vi) huan e marrë nga shtetasi A.Ç, në shumën 2,000,000 lekë, konfirmuar

---

<sup>4</sup>41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

me aktin noterial të datës 29.10.2016; dhe (vii) të ardhurat e siguruar si bashkautor nga shitja e librit “Fjalori i termave të së drejtës, italisht – shqip – italisht”, në shumën 300,000 lekë.

**31.2. Deklarimi i kësaj pasurie në vite:** në deklaratën e interesave private/periodike vjetore, DPV/2005, të depozituar në ILDKPKI, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë e mësipërme me vlerë 74,400 euro dhe se zotëron 50% pjesë takuese të saj, por nuk ka deklaruar burimin e krimit të kësaj pasurie. Në seksionin e detyrimeve financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar detyrimet financiare të krijuara ndaj të tretëve gjatë vitit 2005, si vijon: i) kontratë huaje afatgjatë për blerje apartamenti; huadhënësi “Tirana Bank”, shuma 52,000 euro, afati i shlyerjes 15 vjet, interesi 8% në vit, kësti 487 euro/muaj. Kontrata nr. \*\*\*, datë 16.8.2005. Detyrimi i mbetur 51,000 euro; ii) kontratë huaje për shumën 2,000,000 lekë, datë fillimi 20.6.2005 dhe datë mbarimi 20.6.2010, interesi 5% në vit; huadhënësi A.Ç. Detyrimi i mbetur: i pashënuar në deklaratë.

### **Hetimi/verifikimi i kryer nga Komisioni për këtë pasuri**

**31.3.** Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje rezulton se: i) në datën 3.6.2005 është lidhur kontrata e shitjes me rezervë<sup>5</sup> mes shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., në cilësinë e palës shitëse dhe subjektit të rivlerësimit e bashkëshortes së tij, në cilësinë e palës blerëse, për pasurinë e mësipërme, për çmimin 74,400 euro, me plane pagese: a) shuma 22,400 euro me nënshkrimin e kontratës; dhe b) shuma 52,000 euro me kredi bankare brenda datës 30.7.2005; ii) ndërsa në datën 7.4.2015 është lidhur kontrata e shitjes<sup>6</sup> për këtë pasuri, midis shoqërisë “\*\*\*\*” dhe subjektit të rivlerësimit e personit të lidhur, përfaqësuar me prokurë nga shtetasi A.Ç. Sipas kësaj kontrate, shitësi ka deklaruar se është paguar i plotë çmimi i shitjes, sipas kontratës së shitjes me rezervë të datës 3.6.2005.

**31.4. Në vijim, në datën 14.4.2015** kjo pasuri është regjistruar në ZVRPP-në Tiranë, në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij.

**31.5. Sa më sipër, Komisioni konstaton se në deklaratën “Vetting” subjekti ka kryer deklarim të pasaktë lidhur me vlerën/çmimin e blerjes së kësaj pasurie.**

**31.6.** Referuar deklarimeve të subjektit, si edhe nga dokumentacioni në dosje, pagesa për blerjen e pasurisë është kryer në dy këste në favor të të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k, si vijon: (1) në datën 3.6.2005, nga llogaria e bashkëshortes së subjektit në “Tirana Bank” është transferuar shuma prej 2,770,000 lekësh (konvertuar 22,400 euro); dhe (2) në datën 23.8.2005, nga llogaria e kredisë e hapur në emër të bashkëshortes së subjektit në “Tirana Bank” është transferuar shuma prej 52,000 eurosh.

**31.7.** I pyetur nga Komisioni lidhur me burimin e të ardhurave, të cilat kanë shërbyer për shlyerjen e kësaj të parë, subjekti deklaroi<sup>7</sup>, si burim pagën e tij dhe e bashkëshortes në Shkollën e Magjistraturës, pagën e tij dhe e bashkëshortes si gjyqtar/e, si dhe huan e dhënë nga shtetasi A.Ç si më sipër.

**31.8.** Komisioni verifikoi deklaratat e interesave private/periodike vjetore të depozituara nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur ndër vite në ILDKPKI, nga ku rezultoi se: a) në deklaratën fillestare të pasurisë (dorëzuar nga subjekti në datën 31.3.2004), subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë deklaruar pasuri në formë likuiditetesh; b) në DPV/2004, subjekti ka deklaruar depozitë në të holla në “Tirana Bank”, shumën prej 1,400,000 lekësh dhe se zotëron 50% pjesë takuese të saj. Në këtë deklaratë duket se është shtuar shënimi “*E njëjtë me shumat e deklaruar nga K.Ç (650,000 lekë + 850,000 lekë)*”, shënim i cili mban datën 19.1.2007; c) në deklaratën fillestare të pasurisë si subjekt deklarues (dorëzuar nga bashkëshortja e subjektit

<sup>5</sup> Kontrata e shitjes me rezervë e datës 3.6.2005, konfirmuar me vërtetim nënshkrimi nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 8.6.2006, redaktuar nga noteri publik, znj. R.S.

<sup>6</sup> Kontratë shitje me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 7.4.2015.

<sup>7</sup> Pyetja nr. 1,a), pyetësi nr. 2, përgjigjet e dërguara nga subjekti.

në datën 23.3.2005), personi i lidhur ka deklaruar depozitë në të holla në shumën 850,000 lekë, 100% në emër të saj, viti i krijimit 2004.

**31.9.** Nga verifikimi i dokumentacionit bankar të “Tirana Bank”<sup>8</sup>, rezultoi se gjendja e llogarisë së subjektit të rivlerësimit në datën 31.12.2004 ka qenë 650,000 lekë, ndërsa gjendja e llogarisë së personit të lidhur në datën 31.12.2004 ka qenë në vlerën prej 845,974 lekësh.

**32.** Në vijim, nga analiza e detajuar e llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur në “Tirana Bank”, rezulton se gjendja e llogarisë në datën 31.12.2004, është krijuar nga depozitimet e bëra gjatë vitit 2004 (+ interesat), si vijon: (i) në datën 16.3.2004, personi i lidhur ka depozituar shumën prej 410,000 lekësh; (ii) në datën 15.7.2004, personi i lidhur ka depozituar shumën prej 350,000 lekësh; dhe (iii) në datën 30.8.2004, subjekti ka depozituar shumën prej 650,000 lekësh dhe në total shuma e depozituar deri në këtë datë rezulton në vlerën prej 1,410,000 lekësh.

**32.1.** Komisioni konstaton se vetëm personi i lidhur ka pasur gjendje në llogaritë në “Tirana Bank” në datën 31.12.2003, në shumën 62,762 lekë dhe nuk rezulton të kenë pasur llogari të hapura në banka të tjerë për këtë periudhë. Nisur nga mosdeklarimi i gjendjes *cash* dhe burimit të krijimit të llogarive bankare, Komisioni vlerëson se krahas shumës së mësipërme, si burim krijimi për depozitimet në bankë në vitin 2004, mund të ketë shërbyer vetëm të ardhurat e krijuara gjatë këtij viti.

**33.2.** Bazuar në vetëdeklarimet e subjektit të rivlerësimit, si edhe dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë për periudhën 1.1.2004 – 30.8.2004, të pasqyruar në tabelën si më poshtë:

**Tabela nr. 1.**

Analiza financiare për periudhën 1.1.2004 – 30.8.2004	Vlerat në lekë
<b>A) Pasuri</b>	<b>1, 433, 139</b>
Ndryshim likuiditeti	1, 433, 139
<b>B) Detyrime</b>	<b>0</b>
<b>C) Pasuri neto (A-B)</b>	<b>1, 433, 139</b>
<b>D) Të ardhura</b>	<b>786, 676</b>
Të ardhura nga paga, subjekti i rivlerësimit	441, 526
Të ardhura nga paga, bashkëshortja e subjektit	345, 150
<b>E) Shpenzime</b>	<b>164, 262</b>
Shpenzime jetike	164, 262
<b>Balanca e fondeve (D-C-E)</b>	<b>- 810, 725</b>

**33.3.** Sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht krijimin e likuiditeteve të depozituara në “Tirana Bank” gjatë vitit 2004 (gjendja në llogari bankare deri në datën 30.8.2004).

<sup>8</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 12.03.2020, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 5.5.2020.

**34.** Në vijim, nga verifikimi i lëvizjeve të llogarive në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur në “Tirana Bank”, konstatohen veprimet, transaksionet e kryera gjatë vitit 2005, si më poshtë vijon:

**34.1. Gjendja e llogarisë depozitë e subjektit në datën 31.12.2004, në vlerën prej 650,000 lekë:** i) në datën 3.6.2005 maturohet depozita në shumën prej 668,856 lekë; ii) në datën 3.6.2005, kjo shumë transferohet në llogarinë e personit të lidhur (bashkëshortes së subjektit) në Tirana Bank.

**34.2. Gjendja totale e llogarive depozitë në emër të personit të lidhur në datën 31.12.2004, është në vlerën prej 845,974 lekë** (llogaria me nr. \*\*\* me gjendje 489,823 lekë dhe llogaria me nr. \*\*\* me gjendje 356,151 lekë):

- i. nga llogaria me nr. \*\*\*, në datë 19.1.2005 transferohet në llogarinë \*\*\*, shuma prej 489,823 lekësh. Gjendja e kësaj llogarie në datë 19.1.2005, ka qenë në vlerën 845,974 lekë.
- ii. në datën 21.1.2005, në llogarinë \*\*\*, është tërhequr *cash* shuma prej 489,820 lekësh. Gjendja e kësaj llogarie në datë 21.1.2005, ka qenë në vlerën 356,154 lekë;
- iii. në datën 11.5.2005, në këtë llogari depozitohet *cash* nga personi i lidhur vlera prej 719,800 lekësh. Gjendja e kësaj llogarie në datën 11.5.2005, ka qenë në vlerën prej 1,075,954 lekësh;
- iv. në datën 12.5.2005, shuma prej 1,075,954 lekë investohet në depozitë me afat;
- v. në datën 3.6.2005, në këtë llogari kreditohet shuma prej 668,856 lekësh, nëpërmjet transfertës së bërë nga subjekti i rivlerësimit, siç rezulton më sipër;
- vi. Në datën 3.6.2005, subjekti i rivlerësimit depoziton *cash* në këtë llogari shumën prej 1,050,000 lekësh;
- vii. në datën 3.6.2005, mbyllet para kohe depozita e çelur në datë 12.5.2005, në vlerën prej 1,075,954 lekësh. Gjendja e llogarisë mbas këtij veprimi ka qenë 2,794,811 lekë;
- viii. po në datën 3.6.2005, nga kjo llogari transferohet në favor të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., shuma prej 2,770,000 lekë, me përshkrimin “\*\*\*\*” sh.p.k., *lik 30% blerje shtëpie (22,400 euro)*”.

### **Huaja nga shtetasi A.Ç**

**35.** Siç u konstatua më sipër, në deklaratën “Vetting”, subjekti ka deklaruar si burim krijimi të pasurisë huan e marrë nga shtetasi A.Ç, në shumën 2,000,000 lekë, për të cilën është lidhur kontrata e datës 22.7.2005, konfirmuar para noterit në datën 9.6.2006, si dhe rikonfirmuar me deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 29.10.2016.

**35.1. Deklarimi i kësaj huaje ndër vite:** në DPV/2005 nuk është deklaruar detyrimi i mbetur, ndërsa në deklarimet e viteve 2006-2008, deklarohet si hua e pashlyer. Në vijim, në vitet 2009-2016, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk e kanë deklaruar këtë detyrim financiar, ndërsa në vitin 2018 deklarohet detyrimi i mbetur 1,200,000 lekë. Në DPV/2019 subjekti i rivlerësimit nuk deklaroi të dhëna mbi këtë hua.

**35.2.** Rezulton nga kontrata, ndër të tjera, se “...mospagimi i dy kësteve të njëpasnjëshme sjell zgjidhjen e kontratës së huas”, por përmes një deklarate noteriale, huadhënësi A.Ç ka deklaruar se nga huaja nuk i është paguar asnjë këst, por sipas deklaratës noteriale<sup>9</sup> këtë fakt e ka toleruar për shkak të marrëdhënies miqësore që ka me subjektin e rivlerësimit dhe se huaja është dhënë *cash* në dorë.

<sup>9</sup> Deklarata noteriale me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 29.10.2016, redaktuar nga noteri publik, znj. R.R.



**35.3.** Nëpërmjet pyetësorit nr. 1, subjektit iu kërkua të deklaronte mbi borxhet/huat dhe mënyrën e shlyerjes së tyre, si dhe të depozitonte dokumentacion provues lidhur me marrëdhëniet e mundshme të huas, si edhe mbi burimin e të ardhurave të huadhënësit<sup>10</sup>.

**35.4.** Në përgjigje<sup>11</sup> të pyetësorit, subjekti i rivlerësimit ka rikonfirmuar huan nga shtetasi A.Ç me detyrimin e mbetur të pashlyer në shumën 1,200,000 lekë, por për shkak të kohës së shkurtër deklaroi pamundësinë e paraqitjes së provave mbi burimin e të ardhurave të huadhënësit. Huaja, sipas subjektit, është marrë me qëllim mbulimin e shpenzimeve, edhe pse nuk është cilësuar në kontratë.

**35.5.** I pyetur sërish nga Komisioni<sup>12</sup> për qartësimin e kësaj marrëdhënieje huaje, subjekti i rivlerësimit i ka qëndruar deklaratën se huaja është kthyer pjesërisht në llogarinë e huadhënësit në “Raiffeisen Bank” dhe se është deklaruar edhe në deklaratën vjetore periodike. Ndërsa lidhur me burimin e të ardhurave të huadhënësit ka deklaruar se në dijeni e tij, ky i fundit ka punuar për shumë vite në emigracion dhe si menaxher e agjent shitjesh në disa kompani, por se nuk ka komunikim me të prej vitesh, për shkak të borxhit të pashlyer tërësisht.

**35.6.** Komisioni konstaton se në bazë të kontratës<sup>13</sup> së datës 16.7.2015, personi fizik “A.Ç” regjistruar me Nipt \*\*\*, ka marrë me qira nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, një “njësi shërbimi” prej 44 m<sup>2</sup>, në pronësi të tyre, me qira mujore 172,500 lekë dhe afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 1.5.2015. Por, nga vërtetimi<sup>14</sup> i datës 30.12.2016, personi fizik “A.Ç”, ka deklaruar se është paguar në mënyrë të rregullt qiraja (pjesa e mbetur pas mbajtjes së tatimit në burim 15%) në masën 146,625 lekë në muaj ose në masën 2,932,500 lekë deri në datën 31.12.2016.

**35.7.** Gjithashtu rezulton se pavarësisht datës dhe fillimit të afatit të kontratës së qirasë, subjekti tregtar e ka deklaruar si adresë sekondare biznesi dyqanin e marrë me qira vetëm në datën 11.11.2005.

**35.8.** Pas kërkimit të shpjegimeve nga Komisioni mbi këtë marrëdhënie<sup>15</sup> dhe, konkretisht lidhur me faktin se nga njëra për një periudhë të gjatë kohore nuk ka shlyer huan e marrë nga shtetasi A.Ç, ndërsa nga ana tjetër ky i fundit i ka paguar qira për dyqanin deri në datën 31.12.2016 – në vlerën prej 2,932,500 lekësh, subjekti i rivlerësimit deklaroi se *nuk e ka shlyer huan ndaj tij, pasi ka pasur shpenzime të tjera më të rëndësishme.*

**35.9.** Nga analiza e rrethanave dhe fakteve të konstatuara më sipër, si edhe në vlerësim të deklaratimeve të dhëna nga subjekti gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues vëren se e gjithë marrëdhënia financiare e subjektit të rivlerësimit me shtetasin A.Ç paraqitet kontradiktore dhe pa logjikë ekonomike.

**36.** Në këtë kuptim, Komisioni ngre dyshime të arsyeshme mbi bazën e indicieve të besueshme mbi vërtetësinë e marrëdhënies së huas dhe marrëdhënies së qirasë me këtë shtetas.

**36.1.** Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka konfirmuar si një nga burimet e pagesës së këstit të parë për blerjen e apartamentit huan e marrë nga shtetasi A.Ç. Nga hetimi rezulton se pagesa e këstit të parë është kryer më 3.6.2005, ndërkohë që kontrata e huas është lidhur më 22.7.2005. Gjithashtu, në DPV/2005, si datë fillimi i kontratës së huas deklarohet 20.6.2005. Nga analiza e këtyre fakteve, trupi gjykues arrin në përfundimin se huaja e pretenduar si e marrë nga shtetasi A.Ç, në shumën prej 2,000,000 lekë, nuk mund të ketë shërbyer si burim krijimi për pagesën e këstit të parë të pasurisë objekt vlerësimi.

<sup>10</sup> Pyetësori nr. 1, dërguar me e-mailin e datës 8.1.2020.

<sup>11</sup> Përgjigjet e pyetësorit nr. 1, dërguar nga subjekti me e-mailin e datës 18.1.2020 dhe 20.1.2020.

<sup>12</sup> Pyetja nr. 9 e pyetësorit nr. 2; dërguar me e-mailin e datës 23.9.2020, dhe përgjigjet dërguar nga subjekti me e-mailin e datës 13.10.2020.

<sup>13</sup> Kontrata e qirasë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 16.7.2015. (pjesë e dosjes së ILDKPKI – Aneks \*\*\*).

<sup>14</sup> Pjesë e dosjes së ILDKPKI – Aneks \*\*\*.

<sup>15</sup> Pyetja nr. 9.1 e pyetësorit nr. 2.

**36.2.** Gjithsesi, me qëllimin kryerjen e një hetimi të gjithanshëm dhe shterues, Komisioni vlerëson se në bazë të pikës 14 të nenit 3, si dhe pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, z. A.Ç, bën pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin të justifikojnë ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, në këtë rast, bazuar në parimin e proporcionalitetit, të provojë ligjshmërinë e burimit të të ardhurave, të cilat kanë shërbyer për krijimin e shumës 2,000,000 lekë.

**36.3.** Komisioni konstaton se gjatë hetimit administrativ, por edhe pas kalimit të barrës së provës me dërgimin e rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar asnjë dokumentacion ligjor provues për të ardhurat e personit tjetër të lidhur, shtetasit A.Ç, të cilat pretendohen se kanë mundësuar krijimin e shumës së dhënë hua si më sipër.

**36.4.** Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në përfundimin se personi tjetër i lidhur, z. A.Ç, nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të mundësuar dhënien e huas në favor të subjektit të rivlerësimit.

**36.5.** Konstatohet se në DPV/2005 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura si autor libri (sponsorizime për botim libri dhe fitime nga shitja e librit) në total shumën 250,000 lekë. Komisioni konstaton se, si gjatë hetimit administrativ, ashtu edhe pas kalimit të barrës së provës me dërgimin e rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar asnjë dokumentacion justifikues ligjor për këto të ardhura.

**36.6.** Trupi gjykues, bazuar në analizën e kryer mbi mundësinë e krijimit të likuiditeteve gjendje në bankë në vitin 2004, analizën e kryer lidhur me marrëdhënien e deklaruar të huas me shtetasin A.Ç, si edhe për të ardhurat e deklaruara si autor libri, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të mundësuar kryerjen e pagesës së kështit të parë për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” të ligjit nr. 84/2016.

### **Kredia e marrë në “Tirana Bank”, në shumën 52,000 euro**

**37.** Siç është konstatuar më lart nga analiza e deklaratave “Vetting” dhe DPV/2005, si dhe dokumentacionit bankar konfirmohen të dhënat dhe faktet për kredinë në “Tirana Bank”<sup>16</sup> në shumën 52,000 euro për blerjen e apartamentit.

**37.1.** Pas hetimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit për sa më sipër, konfirmohet<sup>17</sup> se pagesa e kështit të dytë për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi është kryer me fondet e disbursuara nga kredia e marrë në “Tirana Bank” në shumën prej 51,000 euro + shumën prej 1,000 euro, pjesë e fondeve të depozituara *cash* nga subjekti në llogarinë bankare të kredisë në datën 23.8.2005, dhe se në vijim nga kjo llogari po në datën 23.8.2005 transferohet në favor të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., shuma prej 52,000 euro, me përshkrimin “*Likujdim apartamenti*” për rrjedhojë, nuk lindin dyshime lidhur me pagesën e kryer për këtë kësht.

**38. Pasuria e llojit “njësi shërbimi”** me sipërfaqe 44 m<sup>2</sup>, e ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, përfituar në datën 19.10.2012, nëpërmjet dhurimit nga babai i bashkëshortes, z. Sh.Ç. Deklaron se zotëron 50 % pjesë takuese të kësaj pasurie. Vlera e pasurisë pas rivlerësimit 21,000,000 lekë.

<sup>16</sup> Kontratë huaje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 19.8.2005, pjesë e dokumentacionit të dërguar nga “Tirana Bank” në ILDKPKI – ndodhur në aneks \*\*\*.

<sup>17</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 12.03.2020, protokolluar në Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 5.5.2020.

## Hetimi/verifikimi i kryer nga Komisioni për këtë pasuri

**38.1.** Nga hetimi rezulton se: **a)** pasuria me nr. \*\*\*, zona kadastrale \*\*\*, dyqan me sipërfaqe 44 m<sup>2</sup> figuron e regjistruar në emër të z. Sh.Ç, i cili me kontratën e dhurimit<sup>18</sup> të datës 19.10.2012 ua dhuron subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur; **b)** në datën 21.8.2013 në kartelën e pasurisë figuron se pasuria është regjistruar<sup>19</sup> në emër të subjektit dhe personit të lidhur me nr. pasurie \*\*\*, zona kadastrale \*\*\* dhe në datën 26.11.2013 është lëshuar certifikata e pronësisë në emër të tyre. Në kartelën e pasurisë është bërë shënimi i veçantë se vlera e tregut sipas çmimeve të vitit 2012 është 21,000,000 lekë. **c)** në datën 22.12.2017, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij e shesin<sup>20</sup> pasurinë me nr. \*\*\*, për vlerën 100,000 euro.

**38.2.** Sa më sipër, Komisioni konstaton mospërputhje mes numrit të pasurisë së dhuruar me numrin e pasurisë të regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur.

**38.3.** Megjithëse Komisioni i kaloi barrën e provës bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit nuk dha shpjegime lidhur me këto mospërputhje, nëse kemi të bëjmë me të njëjtën pasuri apo dy pasuri të ndryshme, si edhe nuk depozitoi asnjë dokumentacion justifikues ligjor për transaksionet e kryera lidhur me këtë pasuri.

**38.4.** Rezulton nga hetimi se pasuria me nr. \*\*\* në pronësi të z. Sh.Ç ka qenë fillimisht e regjistruar në regjistrin hipotekor nr. \*\*\*, datë 11.12.2009. Kjo pasuri është deklaruar si adresë e ushtrimit të aktivitetit “bar-bufe”, të personit fizik “Sh.Ç”, regjistruar në QKB më 9.6.2009, me NIPT \*\*\*. Adresa rezulton të jetë e njëjta me atë njësisë së shërbimit të dhuruar subjektit të rivlerësimit, pra kjo pasuri ka qenë në përdorim të personit tjetër të lidhur që në vitin 2009.

**38.5.** Në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ<sup>21</sup> për njësinë e shërbimit të dhuruar në favor të tij, subjekti ka deklaruar se aty është ushtruar aktivitet “bar – kafe”. Para se t’i dhurohej, ajo disponohej dhe përdorej nga vjehri i tij, por nuk i kujtohej nëse ai e kishte dhënë me qira apo e administronte vetë lokalin. Gjithashtu, ka deklaruar se pas dhurimit, sipas aktit noterial të datës 18.11.2013<sup>22</sup> ky ambient i është dhënë me qira vëllait të tij, E.Dh, dhe se nuk i kujtohet më pas, pasi, për shkak të falimentimit, lokali ka qenë i mbyllur për disa kohë.

**38.6.** Nga hetimi i kryer në QKB, Komisioni vëren se të dy subjektet tregtare (“Sh.Ç” p.f., dhe “E.Dh” p.f. regjistruar në datën 21.11.2013,) të cilët janë regjistruar me adresë ushtrimi aktiviteti në njësinë e shërbimit të dhuruar në favor të subjektit në tetor të vitit 2012, figurojnë me status “aktiv”.

**38.7.** Siç u konstatua më sipër, rezultoi se subjekti “A.Ç”, ka regjistruar në QKB si adresë sekondare dyqanin e marrë me qira nga subjekti i rivlerësimit në datë 11.11.2015. Në vijim, rezulton se në datën 20.1.2017 e ka hequr si adresë ushtrimi aktiviteti.

**38.8.** Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit nuk dha shpjegime shteruese dhe nuk deklaroi në mënyrë kronologjike për përdorimin e këtij ambienti mbas fitimit të pronësisë prej tij, nuk saktësoi periudhën e përdorimit nga secili subjekt/individ, nëse përdorimi ka qenë me apo pa kundërshtim dhe mbi të ardhurat e mundshme të përfituara prej tij, sipas periudhave përkatëse<sup>23</sup>.

**38.9.** Bazuar në pikën 14 të nenit 3 si dhe pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, z. Sh.Ç, bën pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin të justifikojnë ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, në këtë rast të provojë ligjshmërinë e burimit të të ardhurave, të cilat kanë shërbyer për blerjen e pasurisë së mësipërme.

<sup>18</sup> Kontrata e dhurimit me nr. \*\*\* kol., nr. \*\*\* rep., datë 19.10.2012, redaktuar nga noteri publik, znj. D.K.

<sup>19</sup> Në datën 26.11.2013 është lëshuar certifikata për vërtetim pronësie me nr. \*\*\*, për këtë pasuri.

<sup>20</sup> Kontrata e shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* prot., datë 22.12.2017.

<sup>21</sup> Përgjigjet e pyetësorit nr. 2.

<sup>22</sup> Kontrata e qirasë lidhur me shtetasin E.Dh, me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 16.7.2015, datë 18.11.2013.

<sup>23</sup> Komisioni i kërkoi shpjegime për këtë çështje me dërgimin e rezultateve të hetimit.

**39.** I pyetur nga Komisioni lidhur me dhurimet<sup>24</sup> (datën, shumën, arsyen dhe burimin e krijimit të pasurisë së dhuruar) në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti i rivlerësimit ka rikonfirmuar dhurimin e kësaj pasurie nga vjehtëri i tij. Lidhur me burimin e krijimit të saj nga personi tjetër i lidhur, subjekti ka deklaruar se vjehtëri dhe kunetërit kanë punuar jashtë shtetit në emigracion në Greqi, si edhe kanë ushtruar biznes për vite me radhë tek tregu i \*\*\* me shumicë dhe pakicë. Gjithashtu, ka deklaruar se vjehtëri ka ushtruar dhe veprimtarinë e këmbimit valutor për disa vite, i palicencuar, si rezultat i informalitetit që ka ekzistuar në atë kohë.

**39.1.** I pyetur sërish nga Komisioni<sup>25</sup> lidhur me këtë marrëdhënie dhurimi, duke i kërkuar ndër të tjera të deklarojë mbi mënyrën dhe kohën e fitimit të pasurisë nga personi tjetër i lidhur, si edhe mbi burimin e të ardhurave të dhuruesit, të cilat kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit ndër të tjera deklaroi se koha në dispozicion nuk është e mjaftueshme për të siguruar dokumentacionin, por si burim, në dijeninë e tij kanë shërbyer emigracioni dhe shitja me shumicë të tregu i \*\*\*.

**39.2.** Megjithëse subjektit iu kërkuar në mënyrë të përsëritur, si gjatë hetimit administrativ, ashtu edhe në kalimin e barrës së provës, të depozitonte dokumentacion ligjor justifikues për mënyrën e fitimit të pronësisë dhe burimin e krijimit të të ardhurave nga personi tjetër i lidhur, subjekti i rivlerësimit nuk e depozitoi në asnjë rast dhe nuk deklaroi vlerën e blerjes së pasurisë nga pala dhuruese. Subjekti i rivlerësimit vazhdimisht ka pretenduar se nuk ka pasur kohë të mjaftueshme për të siguruar dokumentacionin.

**39.3.** Sa më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim me parashikimet e bëra në nenin 32/4 të ligjit nr. 84/2016, nuk arriti të provojë ligjshmërinë e burimeve financiare të personit tjetër të lidhur për të mundësuar blerjen e pasurisë së llojit “njësi shërbimi”, të dhuruar në tetor të vitit 2012 në favor të tij dhe personit të lidhur (bashkëshortes).

**40. Pasuria e llojit “njësi shërbimi”** me sipërfaqe 46 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, blerë në datën 17.8.2015. Subjekti ka deklaruar se zotëron ½ pjesë takuese të kësaj pasurie dhe se vlera e pronës pas rivlerësimit është 21,000,000 lekë.

**40.1. Si burim krijimi** të kësaj pasurie ka deklaruar: (i) huan e marrë nga prindërit e bashkëshortes, Sh dhe M.Ç, nëpërmjet llogarisë bankare në “Raiffeisen Bank”, në vlerën totale prej 14,000,000 lekë.

**40.2.** Subjekti ka deklaruar se kjo shumë i është dhënë nëpërmjet bankës, dhe provohet nga deklarata noteriale nr. \*\*\*, datë 29.10.2016 dhe nga *statement* i “Raiffeisen Bank”, printuar në datën 5.1.2017.

**40.3.** Gjithashtu, konstatohet se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting”, subjekti ka deklaruar detyrim ndaj shtetasës M.Ç (nëna e bashkëshortes) që rrjedh nga huaja e marrë pa afat dhe pa interes, e konfirmuar sipas deklaratës noteriale me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 29.10.2016. Viti i krijimit 2016. Qëllimi i detyrimit është për pagesë kësti ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. Shuma e pashlyer në total 700,000 lekë.

**40.4. Deklarimi i kësaj pasurie në vite:** deklaruar në DPV/2005 me të dhënat e mësipërme, likuiduar plotësisht dhe regjistruar në ZVRPP- në Tiranë. Si burim krijimi ka deklaruar: (i) të ardhurat e përfituara sipas VKM-së nr. 909, datë 22.12.2014 për shpronësimin e bar - restorant “\*\*\*\*”, në shumën prej 7,000,000 lekësh; dhe (ii) të ardhura nga qiraja me subjektin “A.Ç” person fizik, në datën 1.5.2015, në shumën prej 500,000 lekë.

Komisioni konstaton se DPV/2015, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar si detyrim financiar huan e marrë nga prindërit e bashkëshortes për blerjen e kësaj pasurie, ndërsa në DPV/2006 ka

<sup>24</sup> Pyetësori nr. 1 (standard), pyetja nr.4.

<sup>25</sup> Pyetja nr. 2 e pyetësorit nr. 2.

deklaruar si detyrim, sipas kontratës së huas ndaj shtetases M.Ç: shlyer shuma prej 14,000,000 lekë nëpërmjet bankës nga kredia bankare; detyrimi i mbetur 700,000 lekë.

### **Hetimi/verifikimi i kryer nga Komisioni për këtë pasuri**

**41.** Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje rezulton se në datën 17.8.2015 personi i lidhur, znj. K.Ç, ka blerë<sup>26</sup> nga shtetasi P.J, pasurinë e mësipërme për çmimin prej 7,500,000 lekësh (pasuria me nr. \*\*\*, zona kadastrale \*\*\*, volum \*\*\*, faqe \*\*\*).

**41.1.** Sipas kontratës së shitblerjes çmimi është likuiduar tërësisht në llogarinë bankare të noteres R.R, në “Alpha Bank”. Rezulton se në datën 20.8.2015 kjo pasuri është regjistruar në ZVRPP-në Tiranë dhe është nxjerrë certifikata për vërtetim pronësie nr. \*\*\*, në emër të personit tjetër të lidhur, znj. K.Ç.

### **42. Verifikimi i kryer për ardhurat e deklaruara si burim për krijimin e kësaj pasurie**

#### **a) Shuma prej 7,000,000 lekë, pjesë e huas së marrë nga prindërit e bashkëshortes**

**a.1)** Bazuar në deklarinimin e subjektit kjo shumë ka si burim të ardhurat e përfituara nga prindërit e bashkëshortes si rrjedhojë e shpronësimit të “\*\*\*\*” (më parë në pronësi të tyre), sipas VKM-së përkatëse.

**a.2)** Nga certifikata për vërtetim pronësie, lëshuar në datën 25.7.2002, z. Sh.Ç, ka pasur të regjistruar në pronësi të tij pasurinë e llojit “arë + truall” me sipërfaqe totale 2,600 m<sup>2</sup>, nga të cilat 190 m<sup>2</sup> truall dhe 190 m<sup>2</sup> ndërtesë. Komuna \*\*\*, Pogradec, me njoftimin për shpronësim publik të datës 9.12.2014, ka identifikuar si pronar të ligjshëm z. Sh.Ç të objektit bar – restorant “\*\*\*\*”, në fshatin \*\*\*, me sipërfaqe truall prej 190 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtesë prej 380 m<sup>2</sup>, ku përcaktohet masa e shpërblimit në shumën prej 311,600 lekësh për truallin dhe në shumën prej 14,400,513 lekësh për ndërtesën. Nëpërmjet VKM-së nr. 909 datë 22.12.2014<sup>27</sup>, është vendosur shpronësimi për interes publik për pasurinë e z. Sh.Ç, dhe është konfirmuar kompensimi financiar në total për shumën prej 14,712,113 lekë, i cili rezulton të jetë kredituar në llogarinë e tij bankare në datën 16.4.2015.

**42.1.** Në vijim, nga verifikimi i dokumentacionit bankar të administruar në dosjen e hetimit administrativ, rezulton se:

- i. në datën 16.4.2015 në llogarinë bankare të personit tjetër të lidhur, z. Sh.Ç, në “Raiffeisen Bank”<sup>28</sup> është kredituar nëpërmjet transfertës shuma prej 14,712,113 lekësh.
- ii. në datën 18.6.2015 nga llogaria e personit tjetër të lidhur, z. Sh.Ç, në “Raiffeisen Bank”, transferohet në favor të personit të lidhur, znj. K.Ç, shuma prej 14,000,000 lekëSH (llogaria në “Raiffeisen Bank”)<sup>29</sup>.
- iii. mbas kreditimit të kësaj shume në llogarinë e personit të lidhur, dhe mbas kthimit të primit lidhur me një kredi të shlyer në mënyrë të parakohëshme, në datë 18.6.2016 gjendja e kësaj llogarie ka qenë në vlerën prej 14,417,476 lekë.
- iv. në datën 23.6.2015, nga kjo llogari e personit të lidhur, transferohet në llogarinë e noteres R.R, shuma prej 7,500,000 lekësh, me përshkrimin “blerje apartamenti nr \*\*\*, ZK \*\*\*, vol \*\*\*”.
- v. nga verifikimi i kryer konstatohet se në kartelën e pasurisë te seksioni “përshkrimi i veçantë”, me kërkesën nr. \*\*\*, datë 22.6.2015, noteri public R.R, ka bërë rezervimin e kësaj pasurie për 30 ditë. Por, gjithsesi, rezulton se fondet e transferuara në llogarinë e noteres R.R në datën 23.6.2015, nuk kanë patur destinacion final shlyerjen e çmimit të

<sup>26</sup> Kontratë shitblerje pasurie të paluajshme me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., redaktuar nga noteri publik, znj. R.R.

<sup>27</sup> <https://qzb.gov.al/eli/fz/2014/202/33d30877-ff07-4102-9aa7-075b0247296f>

<sup>28</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 9.2.2021.

<sup>29</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 25.5.2021.

pasurisë objekt vlerësimi, pavarësisht se përshkrimi i transfertës referon të dhëna të saj, por të një pasurie tjetër, e cila do të trajtohet në vijim.

- vi. në datën 6.8.2015, personi i lidhur, znj. K.Ç, transferon nga llogaria e saj në Raiffeisen Bank – në llogarinë e saj në Tirana Bank, shumën prej 7,001,000 lekë (pjesë e shumës gjendje në datë 18.6.2016, e cila duket se përbëhet nga fondet e transferuara nga z. Sh.Ç, të ardhura të kredituara nga paga, si edhe të ardhurat nga kthimi i primit të sigurimit të evidentuar si më sipër).
- vii. në datën 14.8.2015, llogaria e personit të lidhur në “Tirana Bank”<sup>30</sup> është kredituar me shumën prej 600,000 lekëSH, nëpërmjet transfertës së bërë nga shtetasi A.Ç, me përshkrimin “pagesë qiraje për 4 muaj” dhe gjendja e kësaj llogarie pas kësaj transferte ka qenë në shumën 7,600,900 lekë.
- viii. po në datën 14.8.2015, nga kjo llogari transferohet në llogarinë e noteres R.R – person fizik, shuma 7,500,000 lekë. Referur dokumentacionit të depozituar nga subjekti (SËIFT bankar) konfirmohet se në llogari të noteres R.R pranë Alpha Bank, është transferuar në datën 17.8.2015 shuma 7,500,000 lekë me përshkrimin “Transaksion për tjetërsim pasurie shitblerje prone \*\*\*”.

**42.2.** Nëpërmjet deklaratës noteriale<sup>31</sup> të datës 4.6.2016, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur (bashkëshortja) kanë deklaruar se kanë marrë hua nga Sh dhe M.Ç shumën prej 14,000,000 lekë në vitin 2015, i cili ishte fond i përfituar nga shpronësimi i restorant “\*\*\*\*”, në \*\*\*, Pogradec dhe se këto të ardhura u përdorën prej tyre për blerjen e dy njësive tregtare në Tiranë. Ndërsa, pala huadhënëse, znj. M.Ç, deklaroi se në datë 4.6.2016 i është kthyer mbrapsht e gjithë shuma prej 14,000,000 lekë, të cilat ishin dhënë hua prej saj dhe bashkëshortit, në vitin 2015.

**42.3.** Ndërsa, nëpërmjet deklaratës noteriale<sup>32</sup> të datës 29.10.2016, znj. M.Ç ka deklaruar se, së bashku me bashkëshortin, të ndjerin Sh.Ç, i kanë dhënë hua vajzës së tyre K.Ç dhe dhëndrrit Ken Dhima, shumën prej 14,700,000 lekë në vitin 2015, nga të cilat shuma prej 14,000,000 lekë nëpërmjet bankës dhe 700,000 lekë *cash* për blerjen e dy ambienteve që ato dëshironin të blinin. Burimi i të ardhurave është VKM për shpronësimin e \*\*\* me vendodhje në \*\*\*, Pogradec. Nga kjo shumë vlera prej 14,000,000 lekë i janë shlyer në vitin 2016 pas marrjes së një kredie nga vajza dhe dhëndrri.

**42.4.** Komisioni konstaton mospërputhje në deklaratimet e bëra lidhur me shumën e marrë hua në vitin 2015 nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, për të cilat subjekti i rivlerësimit nuk dha shpjegime edhe pas kalimit të barrës së provës me dërgimin e rezultateve të hetimit.

**42.5.** Për më tepër, referuar burimit të deklaruar nga huadhënësi në deklaratën noteriale të datës 29.10.2016, Komisioni konstaton se vetëm shuma prej 14,000,000 lekë është transferuar në llogari të personit tjetër të lidhur, ndërsa pjesa e mbetur nga vlera e shpronësimit në shumën prej rreth 700,000 lekë (pretenduar si dhënë *cash*), në datën 22.6.2015 është kaluar nga llogaria e z. Sh.Ç, në llogarinë e znj. M.Ç, në “Raiffeisen Bank”, dhe se kjo shumë është investuar në depozitë me afat; dhe që rezultoi si e patërhequr gjatë vitit 2015.

**42.6.** Si rrjedhojë, në analizën financiare të vitit 2015 nuk do të pasqyrohet si e hua shuma prej 700,000 lekë, e pretenduar nga subjekti si e marrë hua gjatë këtij viti nga prindërit e bashkëshortes, krahas shumës prej 14,000,000 lekë.

**42.7.** Gjithsesi, trupi gjykues vlerëson se personat e tjerë të lidhur (prindërit e bashkëshortes së subjektit) kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar dhënien e huas gjatë vitit

<sup>30</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 12.3.2020.

<sup>31</sup> Deklarata noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 4.6.2016, ndodhur aneks \*\*\* në dosjen e ILDKPKI.

<sup>32</sup> Deklarata noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 29.10.2016, pjesë e dosjës së ILDKPKI (aneksi \*\*\*).

2015, në vlerën prej 14,000,000 lekë, konfirmuar kalimi i kësaj shume nëpërmjet transfertës bankare.

**b) Shuma prej 500,000 lekësh, si pjesë e të ardhura të përfituara nga qiradhënia e dyqanit shtetasit, A.Ç**

**42.8.** Komisioni konstaton se në deklaratën “Vetting” subjekti nuk ka deklaruar si burim krijimi të kësaj pasurie të ardhurat e përfituara nga qiradhënia e dyqanit, shtetasit A.Ç, por, nga ana tjetër, rezulton se në DPV/2015 në deklarimin e kësaj pasurie është referuar ky burim. Rezulton gjithashtu sipas informacionit bankar të analizuar më sipër se transfertat e kryer nga z. A.Ç në llogarinë e personit të lidhur në datën 14.8.2015 me përshkrimin “pagesë qiraje për 4 muaj” në vlerën prej 600,000 lekë, ka shërbyer për krijimin e shumës prej 7,500,000 lekësh, fond i transferuar për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi. Gjithashtu, rezulton se në DPV/ 2015, subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiraja prej lokalit në pronësi, sipas kontratës së qirasë me subjektin A.Ç PF, nga data 1.5.2015 deri në datën 31.12.2015, shumën prej 1,200,000 lekë.

**42.9.** Ndërkohë, ka rezultuar nga hetimi se subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrime të pashlyera ndaj shtetasit Ç shumën prej 2,000,000 lekësh, për huan e pretenduar si të marrë prej tij në vitin 2005.

**42.10.** Në këtë kuptim, në kuadrin edhe të dyshimeve të arsyeshme të ngritura për marrëdhënien e qiradhënies mes subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit A.Ç, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka përfiturar të ardhura para datës së nënshkrimit të kontratës së qirasë dhe para regjistrimit të adresës së dyqanit si adresë sekondare e tatimpaguesit “A.Ç”, person fizik.

**42.11.** Si rrjedhojë, në kushtet kur subjekti pas kalimit të barrës së provës nuk dha shpjegime dhe nuk depozitoi prova të reja të mundshme për të kundërshtuar rezultatet e hetimit, trupi gjykues arrin në konkluzion se ai nuk arriti të provojë ligjshmërinë e shumës prej 500,000 lekësh të pretenduar nga marrëdhënia e qiradhënies me shtetasin A.Ç, deklaruar si burim krijimi i kësaj pasurie.

**43. Dy pasuri të llojit “garazh”:** (i) garazh me sipërfaqe 18.9 m<sup>2</sup>, dhe (ii) garazh me sipërfaqe 18.2 m<sup>2</sup>, të ndodhura në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, të blera në datën 10.4.2015 nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., me vlerë 4,500 euro secili. Subjekti ka deklaruar se zotëron ½ pjesë takuese të këtyre pasurive.

**43.1. Si burim krijimi** ka deklaruar: (i) të ardhurat nga paga si gjyqtar; (ii) të ardhurat nga paga e bashkëshortes si gjyqtare; dhe (iii) të ardhurat nga qiraja e ambientit, njësia e shërbimit në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë (kontrata e qirasë lidhur me shtetasin E.Dh, me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 16.7.2015, datë 18.11.2013).

**43.2. Deklarimi i kësaj pasurie në vite:** Komisioni konstaton se në kundërshtim me parashikimet e bëra në germën “a” të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike”, i ndryshuar, subjekti nuk ka deklaruar këto dy pasuri të paluajtshme, të drejtat reale mbi to.

**Hetimi/verifikimi i kryer nga Komisioni për këto pasuri**

**44.** Rezulton se me kontratën<sup>33</sup> e datës 10.4.2015 subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur (përfaqësuar me prokurë nga shtetasi A.Ç), kanë blerë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., dy pasuri të llojit garazh: (i) garazh me nr. pasurie \*\*\*, volumi \*\*\*, faqe \*\*\*, me sipërfaqe 18.9 m<sup>2</sup>, ndodhur në zona kadastrale \*\*\*, me adresë: rruga “\*\*\*\*”, Tiranë; dhe (ii) garazh me nr. pasurie \*\*\*, volumi \*\*\*, faqe \*\*\*, me sipërfaqe 18.2 m<sup>2</sup>, ndodhur në zonën kadastrale \*\*\*, me adresë: rruga “\*\*\*\*”, Tiranë, për çmimin në total prej 9,000 euro, e konvertuar në shumën 1,262,520

<sup>33</sup> Kontratë pronotimi nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 10.4.2015, redaktuar nga noteri publik, znj. M.D, (aneks \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së).

lekë (secili me çmim 4,500 euro – konvertuar në shumën 631,260 lekë). Referuar kontratës, shitësi e ka paguar paraprakisht të gjithë çmimin shitjes në shumën 9,000 euro, sipas mandatit me nr. veprimi \*\*\* dhe referencë \*\*\*, lëshuar nga “Raiffeisen Bank”.

**44.1.** Konfirmohet gjithashtu se këto pasuri janë të regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij<sup>34</sup>.

**44.2.** Rezulton gjithashtu se shtetasi A.Ç në datën 10.4.2015 ka depozituar *cash* shumën prej 9,000 euro në “Raiffeisen Bank” dhe e ka kaluar këtë shumë në favor të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me përshkrimin “*Per Ken Dhima derdh A.C sip kontr rep \*\*\* kol \*\*\* dt 10/04/2015 garazh 1 garazh 2*”<sup>35</sup>.

### **Verifikimi i kryer për ardhurat e deklaruara si burim për krijimin e kësaj pasurie**

**44.3.** Siç u konstatua më sipër, në deklaratën “Vetting” subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi të këtyre pasurive (i) të ardhurat nga paga të tij dhe të bashkëshortes, dhe (ii) të ardhurat nga qiradhënia e dyqanit të ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, ndërsa në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar si burim të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes.

**44.4.** Sa më sipër, Komisioni konstatoi mospërputhje në deklaratimet bëra lidhur me burimin e krijimit të pasurive objekt vlerësimi, për të cilat subjekti nuk dha shpjegime edhe pas kalimit të barrës së provës me dërgimin e rezultateve të hetimit.

**44.5.** Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore, të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit ndër vite në ILDKPKI konstatohet se për periudhën 2003 – 2014 subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk kanë deklaruar kursime në formë likuiditetesh *cash* me burim krijimi të ardhurat e tyre nga pagat.

**44.6.** Ndërsa, në DPV/2014 në seksionin “*Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit*”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar vlerën prej 1,400,000 lekë, me pëshkrim dhe burim krijimi: “*Para kesh jashtë sistemit bankar si rezultat i qirasë së lokalit në pronësinë time dhe të bashkëshortes*”, të cilat rezultojnë të lidhen me marrëdhënien e qiradhënies me shtetasin E.Dh. Referuar dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, lidhur me këtë marrëdhënie qiraje, rezulton se për vitin 2014 është mbajtur, deklaruar, dhe paguar tatim në burim nga subjekti tregtar “E.Dh” person fizik, shuma 180,000 lekë, për vlerën e qirasë së deklaruar në shumën prej 1,800,000 lekësh.

**44.7.** Por, gjithsesi Komisioni vëren se krahas mosdeklarimit së këtyre dy pasurive në DPV/2015, subjekti gjithashtu nuk ka deklaruar pakësimin e gjendjes *cash* të deklaruar në DPV/2014 si burim krijimi të këtyre pasurive. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se këto likuiditete nuk mund të kenë shërbyer si burim krijimi i dy pasurive të llojit garazh<sup>36</sup>, të blera në datë 10.4.2015.

**44.8.** Ndërsa, në DPV/2015 subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiraja prej lokalit në pronësi sipas kontratës së qirasë me shtetasin E.Dh, nga data 1.1.2015 deri më datë 30.4.2015, në shumën prej 600,000 lekë. Por, rezulton se subjekti nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të provuar pagesën e tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga qiraja për vitin 2015.

<sup>34</sup> Shkresa “kthim përgjigje” e ZVRPP-së Tiranë me nr. \*\*\* prot., datë 18.4.2018 – pjesë e dosjes së ILDKPKI-së, si edhe dokumentacioni i depozituar nga subjekti në ILDKPKI për këto dy pasuri (ndodhur Aneks \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së).

<sup>35</sup> Mandat pagesa ndodhur Aneks \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>36</sup> Subjekti nuk dërgoi prapësimet e tij, pra, nuk dha shpjegime dhe nuk depozitoi prova për të kundërshtuar konstatimin e bërë nga Komisioni me dërgimin e rezultateve të hetimit.



**44.9.** Në kushtet kur, kontrata e qiradhënies është lidhur mes subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit E.Dh, si individ, referuar legjislacionit tatimor<sup>37</sup>, rezulton se për këto të ardhura të paguara nga E.Dh si individ, përfituesi i të ardhurave (subjekti i rivlerësimit) është i detyruar të deklarojë dhe të paguajë në organin tatimor tatimin përkatës për to.

**44.10.** Komisioni thekson sërish faktin se, edhe pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit nuk dha shpjegime dhe nuk depozitoi dokumentacion justifikues ligjor për të provuar të ardhurat e deklaruara si të përfituara nga qiradhënia e lokalit, shtetasit E.Dh, gjatë vitit 2015. Si rrjedhojë, të ardhurat e pretenduara për vitin 2015 nga qiradhënia, nuk do të përfshihen në analizën financiare të kryer nga Komisioni.

**44.11.** Bazuar në vetëdeklarimet e subjektit të rivlerësimit si edhe dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë për periudhën 1.1.2015 – 10.4.2015 (data e blerjes së dy garazheve objekt vlerësimi), të pasqyruar në tabelën si më poshtë:

**Tabela nr. 2.**

<b>Analiza financiare, periudha 1.1.2015 – 10.4.2015</b>	<b>Vlerat në lekë</b>
<b>A) Pasuri</b>	<b>1, 734, 641</b>
Dy pasuritë e llojit “garazh”, blerë në datën 10.4.2015, në vlerën 9,000 euro.	1, 262, 520
Ndryshim likuiditeti	472, 121
<b>B) Detyrime</b>	<b>0</b>
<b>C) Pasuri neto (A-B)</b>	<b>1, 734, 641</b>
<b>D) Të ardhura</b>	<b>726, 575</b>
Të ardhura nga paga, subjekti i rivlerësimit	363, 047
Të ardhura nga paga e bashkëshortes	363, 528
<b>E) Shpenzime</b>	<b>507, 132</b>
Shpenzime jetike	245, 782
Shpenzime për kredinë në Raiffeisen Bank	261, 350
<b>Balanca e fondeve (D-C-E)</b>	<b>- 1 515 198</b>

**44.12.** Sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar blerjen e pasurive të mësipërme, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” të ligjit nr. 84/2016.

**45. Pasuria e llojit “njësi shërbimi” me sipërfaqe 47 m<sup>2</sup>,** ndodhur në rrugën “\*\*\*\*” Tiranë, prenotuar në datë **16.7.2015** nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., për çmimin prej 7,500,000 lekë. Subjekti deklaron se zotëron ½ pjesë takuese të kësaj pasurie.

**45.1. Si burim krijimi** të kësaj pasurie ka deklaruar: (i) të ardhurat nga paga si gjyqtar; (ii) të ardhurat nga paga e bashkëshortes si gjyqtare; (iii) huaja e dhënë nga prindërit e bashkëshortes Sh.Ç dhe M.Ç, nëpërmjet llogarisë bankare në “Raiffeisen Bank” në vlerën totale 14.000.000

<sup>37</sup> Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, dhe udhëzimit nr. 5, datë 30.1.2006 të ministrit të Financave.

lekë; (iv) të ardhurat nga qiradhënia e ambientit të shërbimit me adresë: rruga “\*\*\*\*”, Tiranë, lënë me qira shtetasit A.Ç, i cili ka zhvilluar veprimtari tregtare.

**45.2 Deklarimi i kësaj pasurie në vite:** referuar deklaratës periodike vjetore të vitit 2015 konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *ambjent me sipërfaqe 235.18 m<sup>2</sup> i përbërë nga 4 njësi (nr \*\*\*, \*\*\*, \*\*\* dhe \*\*\*) në rrugën “\*\*\*\*”, përballë \*\*\* me kontratë prenotimi, pronë e tipit karabina me leje ndërtimi. Kontrata e parë me nr. \*\*\* rep., nr \*\*\* kol., datë 16.7.2015, dhe kontratë e dytë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 16.7.2015 para noteres R.R. Paguar totalisht kontrata e parë. Shuma 7,500,000 lekë. Burimi është VKM për shpronësim me nr 909 datë 22.12.2014 të bar restorant “\*\*\*\*”, kontrata e dytë e palikuiduar.*

#### **Hetimi/verifikimi i kryer nga Komisioni për këtë pasuri**

**45.3.** Rezulton se, me kontratën<sup>38</sup> e datës 16.7.2015 subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë porositur nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., pasurinë e llojit njësi shërbimi me sipërfaqe 47 m<sup>2</sup>, dyqani nr. \*\*\*, Seksioni \*\*\*, në objektin që po ndërtohej nga kjo shoqëri në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë.

**45.4.** Referuar kësaj kontrate, çmimi i përcaktuar midis palëve për shitjen e kësaj pasurie është 7,500,000 lekë, dhe se shuma është likuiduar tërësisht me nënshkrimin e saj, nëpërmjet llogarisë së noteres R.R në “Raiffeisen Bank”. Rezulton se, kontrata për shitblerjen<sup>39</sup> e kësaj pasurie është nënshkruar në datën 5.10.2018.

#### **Verifikimi i kryer për ardhurat e deklaruara si burim për krijimin e kësaj pasurie**

**45.5.** Siç u konstatua më sipër, në datën 18.6.2015, nga llogaria e personit të lidhur, z. Sh.Ç, në “Raiffeisen Bank” është transferuar në favor të personit të lidhur, znj. K.Ç, shuma prej 14,000,000 lekësh (llogaria në “Raiffeisen Bank”), me burim të ardhurat e përfituara nga shpronësimi për interes publik i bar-restorant “\*\*\*\*” (trajtuar si më sipër).

**45.6.** Rezulton se nga kjo llogari e personit të lidhur në datën 23.6.2015 transferohet në llogarinë e noteres R.R, shuma prej 7,500,000 lekësh dhe në vijim rezulton se këto fonde, në datën 16.7.2015 transferohen nga llogaria noterit<sup>40</sup> në favor të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me përshkrimin “*Lik kontrate nr \*\*\* Rep nr \*\*\* Kol, datë 16.07.2015*”.

**45.7.** Trupi gjykues, pas verifikimit, konstaton se si burim për pagesën e kryer për likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi kanë shërbyer të ardhurat e marra hua nga prindërit e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, ligjshmëria e të cilave është analizuar si më sipër në këtë vendim. Gjithsesi, Komisioni thekson faktin se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting” subjekti nuk ka deklaruar saktësisht burimin e krijimit të kësaj pasurie.

**46. Pasuria/pasuritë e llojit “njësi shërbimi” me sipërfaqe totale 188.18 m<sup>2</sup>,** e përbërë përkatësisht nga pasuritë me sipërfaqe (i) 47.23 m<sup>2</sup>; (ii) 42.62 m<sup>2</sup>; dhe (iii) 98.33 m<sup>2</sup>, të ndodhura në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, porositur në datën 16.7.2015 nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., me vlerë totale 246,429 euro, nëse merren në dorëzim të përfunduara plotësisht dhe me vlerë 105,000 euro, nëse merren në dorëzim në gjendje karabina. Deklaron se zotëron ½ pjesë takuese mbi këto pasuri.

**46.1.** Gjithashtu, vërehet se në seksionin e detyrimeve financiare ndaj *personave juridikë dhe fizikë* lidhur me porositjen e këtyre njërive të shërbimit, subjekti ka deklaruar detyrim të

<sup>38</sup> Kontratë prenotimi nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 16.7.2015, redaktuar nga noteri publik, znj. R.R, (aneks \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së).

<sup>39</sup> Kontrata e shitje pasurie të paluajtshme nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 5.10.2018. (Kontratë e dëguar nga noteri publik znj. M.Sh me shkresën e datës 2.6.2021, protokolluar në KPK nr. \*\*\* prot., datë 6.6.2021).

<sup>40</sup> Subjekti ka depozituar dokumentin bankar “njoftim debitimi”, datë 16.7.2015 (ndodhur Aneks \*\*\*, në dosjen e ILDKPKI).

pashlyer ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., në shumën prej 196,429 euro, nëse merren në dorëzim të përfunduara, dhe detyrim në shumën prej 55,000 euro, nëse merren në dorëzim karabina.

**46.2. Si burim krijimi** të këtyre pasurive ka deklaruar: (i) të ardhurat nga paga si gjyqtar, (ii) të ardhurat e bashkëshortes nga paga si gjyqtare; (iii) kredia e marrë në “Societe Generale Bank”, në shumën prej 21,000,000 lekësh (kontrata e kredisë bankare nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 9.5.2016); (iv) të ardhurat nga qiraja e ambientit, njësia e shërbimit në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë (kontrata e qirasë lidhur me shtetasin A.Ç, me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 16.7.2015); (v) të ardhura nga qiraja e ambientit “njësi shërbimi” në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë (kontrata e qirasë lidhur me Postën Shqiptare sh.a., me nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2016).

**46.3. Deklarimi i kësaj pasurie në vite:** Në DPV/2015, subjekti ka deklaruar pasurinë e llojit “ambient” me sipërfaqe 235.18 m<sup>2</sup> (e përbërë nga 4 njësi), ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, pronë e tipit karabina, me leje ndërtimi, përfituar me kontratat e prenotimit: (i) kontrata e parë me nr. \*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë 16.7.2015 dhe, (ii) kontrata e dytë nr \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 16.7.2015, para noteres R.R. Pagar totalisht kontrata e parë, shuma 7,500,000 lekë. Burimi është VKM-ja për shpronësim me nr. 909, datë 22.12.2014, të bar restorant “\*\*\*\*”. Kontrata e dytë e palikuiduar.

**46.4.** Ndërsa, në seksionin e detyrimeve financiare ndaj personave juridikë e fizikë ka deklaruar: *“Detyrim që rrjedh nga kontrata e dytë nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol., datë 16.7.2015, para noteres R.R lidhur me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. Qëllimi i kontratës - blerje pasurie e paluajtshme, fillimi i detyrimit shtator 2015, dhe mbarimi i detyrimit gusht 2017. Shuma e detyrimit të mbetur 246,429 euro”.*

**46.5.** Në DPV/2016, në seksionin *“detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Detyrimi ndaj shoqërisë \*\*\* Shpk, lidhur me blerjen e një njësie shërbimi e vërtetuar me kontratën e prenotimit me nr. \*\*\* rep., \*\*\* kol., datë 16.7.2015 (Karabina). Shlyer vlera 50,000 euro nëpërmjet bankës nga kredia bankare e marrë, dhe gjendja e detyrimit të mbetur është 55,000 euro”.*

### **Hetimi/verifikimi i kryer nga Komisioni për këto pasuri**

**46.6.** Rezulton se me kontratën e prenotimit<sup>41</sup> të datës 16.7.2015, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë porositur nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., në objektin e ndërtuar/që po ndërtonte kjo shoqëri në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, 3 pasuri të llojit “njësi shërbimi”, si vijon:

- (i) njësi shërbimi me sipërfaqe 47.23 m<sup>2</sup>, dyqani nr. \*\*\*; Seksioni \*\*\*;
- (ii) njësi shërbimi me sipërfaqe 42.62 m<sup>2</sup>, dyqani nr. \*\*\*; Seksioni \*\*\*;
- (iii) njësi shërbimi me sipërfaqe 98.33 m<sup>2</sup>, dyqani nr. \*\*\*; Seksioni \*\*\*.

**46.7.** Në këtë kontratë është përcaktuar se, vlera totale e shitblerjes dhe prenotimit për këto pasuri është në shumën **246,429 euro**. Por, nga ana tjetër, në rast se palët bien dakord në vijim ndërmjet tyre që ambientet e mësipërme do të dorëzohen në gjendje karabinaje, pa punime të rifiniturës, çmimi total për këto njësi të prenotuara do të jetë **105,000 euro** dhe kjo do të vërtetohet me deklaratë noteriale ndërmjet palëve.

**46.8.** Plani i pagesave/mënyra e likuidimit është përcaktuar si vijon, (i) me nënshkrimin e kontratës do të bëhet pagesa e kështit të parë në vlerën prej 50,000 euro, brenda muajit shtator 2015; (ii) kështi i dytë, në vlerën 50,000 euro, do të likuidohet brenda muajit mars 2016; (iii) kështi i tretë, në vlerën 50,000 euro, do të likuidohet brenda muajit nëntor 2016; (iv) kështi i katërt, në vlerën 50,000 euro, do të likuidohet brenda muajit prill 2017; (v) kështi i pestë dhe i fundit, në vlerën 46,429 euro, do të likuidohet brenda muajit gusht 2017. Gjithashtu, në këtë kontratë parashikohet se likuidimi i të gjithë shumave të mësipërme do të bëhen nga pala porositëse në llogaritë e sipërmarrësit ndërtues “\*\*\*\*” sh.p.k., pranë bankave të nivelit të dytë.

<sup>41</sup> Kontrata e prenotimit nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 16.7.2015, redaktuar nga notere R.R.

**46.9.** Bazuar në përcaktimet e bëra në kontratën e prenotimit<sup>42</sup> të datës 16.7.2015, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë për periudhën 1.1.2015 – 30.9.2015, me qëllim verifikimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për kryerjen e pagesës së kështit të parë në shumën 50,000 euro, për blerjen e 3 pasurive objekt vlerësimi, të pasqyruar në tabelën si më poshtë:

**Tabela nr. 3.**

<b>Analiza financiare për periudhën 1.1.2015 – 30.9.2015</b>	<b>Vlerat në lekë</b>
<b>A) Pasuri</b>	<b>50,893,018</b>
Dy pasuritë llojit “garazh”, (i) me sipërfaqe 18.9 m <sup>2</sup> , dhe (ii) me sipërfaqe 18.2 m <sup>2</sup> , blerë në nga shoqëria “****” sh.p.k., në vlerën 9,000 euro.	1,262,520
Njësi shërbimi me sip. 46 m <sup>2</sup> , ndodhur në rrugën “****” ***, Tiranë	7,500,000
Njësi shërbimi nr. ***, me sipërfaqe 47 m <sup>2</sup> , e ndodhur në rrugën “****”, Tiranë.	7 500 000
Njësitë e shërbimit nr. ***, ***, ***, me sipërfaqe totale 188.18 m <sup>2</sup> , të ndodhura në rrugën “****”, Tiranë, porositur te shoqëria “****” sh.p.k.	33 920 952
Ndryshim likuiditeti	709 546
<b>B) Detyrime</b>	<b>41 038 452</b>
Hua të mara ndaj palëve të treta, Sh.Ç dhe M.Ç	14 000 000
Detyrim i mbetur ndaj shoqërisë “****” sh.p.k.,	27 038 452
<b>C) Pasuri neto (A-B)</b>	<b>9 854 566</b>
<b>D) Të ardhura</b>	<b>2 358 069</b>
Të ardhura nga paga, subjekti i rivlerësimit	816 857
Të ardhura nga paga e bashkëshortes	808 087
Të ardhura nga qiraja e dyqanit në rrugën “****”, Tiranë	733 125
<b>E) Shpenzime</b>	<b>7 608 776</b>
Shpenzime jetike	663 611
Shpenzime për kredinë tek “Raiffeisen Bank”, disbursuar në datën 8.10.2010	5 903 391
Shpenzime për udhëtime jashtë vendit	164 492
Shpenzime për arsimin e vajzës	877 282
<b>Balanca e Fondeve (D-C-E)</b>	<b>-15 105 273</b>

**46.10.** Sa më sipër rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar pagesën e kështit të parë për blerjen e pasurive objekt vlerësimi.

**46.11.** Megjithëse, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit për të dhënë argumentet/shpjegimet dhe provat e tij në lidhje me konstatimin e mësipërm, rezulton se subjekti nuk dërgoi prapësimet e tij, pra, nuk paraqiti shpjegime dhe nuk depozitoi prova për të kundërshtuar rezultatin e hetimit.

**46.12.** Si përfundim, trupi gjykues i qëndron konstatimit dhe rezultatit fillestar, se subjekti rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar pagesën e kështit të parë për likuidimin e çmimit të pasurive objekt vlerësimi, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” të ligjit nr. 84/2016.

**47.** I pyetur nga Komisioni në lidhje me këto 3 njësi shërbimi<sup>43</sup>, subjekti i rivlerësimit ndër të tjera ka deklaruar se pasuria/pasuritë është/janë blerë karabina në shumën prej 105,000 euro dhe se të gjitha pagesat janë bërë nëpërmjet noteres R.R, me bankë. Gjithashtu, ka deklaruar se

<sup>42</sup> Kontrata e prenotimit nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 16.7.2015, redaktuar nga notere R.R.

<sup>43</sup> Pyetja nr. 8 e pyetësorit nr. 2.

burimi i krijimit të këtyre pasurive është ai i referuar në deklaratën vjetore<sup>44</sup> dhe në deklaratën “Vetting” edhe se nuk ka kryer asnjë investim në këtë pasuri/këto pasuri.

**47.1.** Referuar informacionit/dokumentacionit të dërguar nga OTP Bank<sup>45</sup>, konfirmohet se në datën 9.5.2016, midis bankës dhe subjektit të rivlerësimit e personit të lidhur, është lidhur kontrata e huas për shumën 21,000,000 lekë, me objekt investimin në pasuri të paluajtshme. Si kushte lëvrimit në këtë kontratë janë parashikuar: (i) të paraqitet para disbursimit konfirmimi nga shitësi për shumën totale të transaksionit të 3 njësive që po blihen dhe të cilësohet statusi i tyre karabina; (ii) fondet e kredisë në shumën prej 14,000,000 lekësh të kalojnë me transfertë në llogarinë e huadhënësve (prindërve të klientes); dhe (iii) shuma prej 7,000,000 lekësh të kalojë në llogari të shitësit/noterit.

**47.2.** Garancia e ofruar për sigurimin e kredisë është përcaktuar të jetë hipoteka mbi pasurinë e paluajtshme të llojit “njësi” me sipërfaqe 44 m<sup>2</sup> dhe me numër pasurie \*\*\*, ndodhur në zonën kadastrale nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, me adresë rruga “\*\*\*\*”, Tiranë, dhe hipoteka mbi pasurinë e paluajtshme në pronësi të K.Ç, e llojit “njësi shërbimi” me sipërfaqe 46 m<sup>2</sup>, me numër pasurie \*\*\*, ndodhur në zonën kadastrale nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, me adresë rruga “\*\*\*\*”, Tiranë.

**47.3.** Referuar lëvizjeve të llogarisë bankare në “OTP Bank” konfirmohet se në datën **18.5.2016** është disbursuar kredia në vlerën 21,000,000 lekë, në llogarinë dyemërore të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur (bashkëshortes) pranë kësaj banke, dhe se në datën **19.5.2016** shuma 7,000,000 lekë është transferuar në llogari të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k, me përshkrimin “*Kalim fondi sipas kontratës së prenotimit nr. \*\*\* rep., nr \*\*\* kol., datë 16.7.2015*”. Ndërsa, pjesa tjetër e fondeve me burim nga kredia në shumën prej 13,851,000 lekë, në datë 23.5.2016 janë tranferuar në llogarinë dyemërore të subjektit dhe personit të lidhur në BKT dhe, në vijim, e gjithë shuma është tërhequr *cash* nga subjekti dhe personi i lidhur në tri pjesë, si vijon: (i) në datën 27.5.2016 tërhequr shuma prej 8,000,000 lekësh; (ii) në datën 30.5.2015 tërhequr shuma 4,000,000 lekë; dhe (iii) në datën 3.6.2016 tërhequr shuma 1,850,000 lekë.

**47.4.** Pas kërkesës së bërë nga Komisioni<sup>46</sup>, noterët publikë, znj. R.R<sup>47</sup> dhe znj. M.Sh<sup>48</sup>, dërguan dokumentacion si kontrata dhe deklarata noteriale, të lidhura me këto 3 njësi shërbimi, nga verifikimi i të cilit rezulton se:

- a) Me deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., të datës **13.5.2016**, redaktuar nga noteri publik, znj R.R, sipërmarrësi “\*\*\*\*” sh.p.k., dhe porositësit, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, deklarojnë se: “*Kanë nënshkruar midis tyre një kontratë pronotimi nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 16.7.2015, për pronotimin, nga pala porositëse, të tre njësive, respektivisht (1) Pasuria e Llojit Njësi me sipërfaqe 47.23 m<sup>2</sup>, dyqani nr. \*\*\*, (2) Pasuria e Llojit Njësi me sipërfaqe 46.42 m<sup>2</sup>, dyqani nr. \*\*\*, (3) Pasuria e Llojit Njësi me sipërfaqe 98.83 m<sup>2</sup>, dyqani nr. \*\*\*. Për sa më sipër, bazuar edhe në parashikimin e bërë në kontratën e pronotimit të cituar më lart, në nenin 1, Objekti i Kontratës, Pala Sipërmarrëse deklaron se bie dakort që t’i dorëzojë Palës Porositëse, ambientet e sipërcituara, në gjendje karabinaje pa punime të rifiniturës, çmimi total për këto njësi të pronotuara do të jetë 105,000 euro (njëqind e pesë mijë euro).*”
- b) Referuar deklaratës noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë **15.6.2016**, redaktuar nga noteri publik, znj R.R, sipërmarrësi “\*\*\*\*” sh.p.k., dhe porositësit, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, deklarojnë se: “*Kanë nënshkruar midis tyre një kontratë pronotimi nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 16.7.2015, për pronotimin nga Pala Poroistëse, të 3 (tre) Njësive, si dhe*

<sup>44</sup> U referohet deklaratave të interesave privatë/periodikë vjetor të depozituar në ILDKPKI.

<sup>45</sup> Shkresa nr. \*\*\* – \*\*\* prot., datë 12.3.2020.

<sup>46</sup> Shkresat nr. \*\*\* prot., dhe \*\*\* prot, të datës 27.5.2021.

<sup>47</sup> Shkresa e datës 10.6.2021, protokolluar në Komision nr. \*\*\* prot., datë 14.6.2021.

<sup>48</sup> Shkresa e datës 2.6.2021, protokolluar në Komision nr. \*\*\* prot., datë 4.6.2021.

*një deklaratë Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 13.5.2016, për përcaktimin e mënyrës së dorëzimit të ambienteve, objekt i Kontratës së Pronotimit. Për sa më sipër, bazuar në negociatat e zhvilluara midis palëve në marrëdhënie (për shkak se nuk është rënë dakort për disa volume punimesh të cilat ishte rënë dakort gojarisht për tu kryer), **palët bien dakort të anullojnë deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 13.5.2016, për përcaktimin e mënyrës së dorëzimit të ambienteve objekt i kontratës së Pronotimit, duke deklaruar se këtë gjë do ta përcaktojnë në momentin e marrjes në dorëzim të ambienteve.***

- c) Në vijim rezulton se, me anë të deklaratës **nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 4.6.2018**, redaktuar nga noteri publik, znj R.R, sipërmarrësi “\*\*\*\*” sh.p.k., dhe porositësit, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, deklarojnë se: *“Kanë nënshkruar midis tyre një kontratë Prenotimi nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 16.7.2015, për prenotim nga Pala Porositëse të 3 (tre) Njësive, si edhe një deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 13.5.2016, për përcaktimin e mënyrës së dorëzimit të ambienteve, objekt i kontratës së prenotimit. Gjithashtu, bazuar në negociatat e zhvilluara midis palëve në marrëdhënie, palët kanë rënë dakort të anullojnë deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 13.5.2016, për përcaktimin e mënyrës së dorëzimit të ambienteve, objekt i kontratës së prenotimit, duke deklaruar se këtë gjë do ta përcaktojnë në momentin e dorëzimit të ambienteve. Në datë 20.1.2018, Sipërmarrësi, Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “\*\*\*\*” sh.p.k., me administrator, z. R.B, i dorëzoi Porositësit Ken Dhima dhe K.Ç ambientin në gjendje karabinaje pa punime të rifiniturës me çmim total 105,000 euro, sipas kontratës së prenotimi nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 16.7.2015, për prenotimin e tre njësive, respektivisht: (1) Pasuria e Llojit Njësi me sipërfaqe 47.23 m2, dyqani nr. \*\*\*, (2) Pasuria e Llojit Njësi me sipërfaqe 46.42 m2, dyqani nr. \*\*\*, (3) Pasuria e Llojit Njësi me sipërfaqe 98.83 m2, dyqani nr. \*\*\*.*
- d) Në datën **5.10.2018** është nënshkruar kontrata **nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol.**, për shitblerjen e njësive objekt vlerësimi (redaktuar nga noteri publik, znj. M.Sh), në të cilën përcaktohet çmimi total i tyre në vlerën prej 105,000 euro.
- e) Gjithashtu rezulton se, **me anë të deklaratës noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 5.11.2019**, redaktuar nga noteri publik, znj. M.Sh, sipërmarrësi “\*\*\*\*” sh.p.k., dhe porositësit, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, deklarojnë se: *“Me njëri tjetrin kanë nënshkruar dy kontrata sipërmarrje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 16.7.2015, për marrëveshje ndërtimi nga shoqëria e sipërcituar një njësi të emërtuar me nr. \*\*\* me vlerë 7,500,000 lekë, si dhe kontratën e sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 16.7.2015 për marrëveshje ndërtimi nga shoqëria e sipërcituar tre njësi të emërtuar me nr. \*\*\*, \*\*\*, \*\*\* me vlerë 246,429 euro. Gjithashtu në kontratën e sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 16.7.2015, thuhet se në rast se ambientet e mësipërme do të dorëzohen karabina pa rifinitura, do të kenë një vlerë totale 105,000 euro. Sot përpara noterit, palët sa më sipër deklarojnë se shuma në total për blerjen e katër ambienteve (4-njësive) është dorëzuar në gjendjen karabina dhe pa rifinitura. Pra vlera e tyre përfundimisht në total do të ishte në shumën 105,000 euro (njëqind e pesëmijë) euro, shumë e cila është shlyer në total sipas mandateve dhe se palët nuk kanë asnjë pretendim ndaj njëri- tjetrit.*

**47.5.** Në analizë të rrethanave dhe provave të mësipërme, trupi gjykues çmon se deklarata noteriale e datës 13.5.2016 është bërë me qëllim përmbushjen e kushtit për të përfutur kredinë në “OTP Bank” (kontrata e kredisë nënshkruar në datën 9.5.2016, disburësimi i shumës prej 21,000,000 lekë në datë 18.5.2016).

**47.6.** Gjithashtu, nga verifikimi dhe analizimi në tërësi i deklaratave noteriale të cituara si më sipër vërehet se, në momentin e dorëzimit të deklaratës vetting por edhe në vijim gjatë vitit 2017 nuk ka patur marrëveshje në fuqi mes palëve për marrjen në dorëzim të pasurive objekt vlerësimi në gjendje karabina. Si rrjedhojë, në referim të kontratës së prenotimit të datës

16.7.2015, në kushtet e mungesës së marrëveshjes mes palëve, çmimi i plotë në shumën 246,429 euro, do të duhej të paguhej brenda muajit gusht të vitit 2017, sipas përcaktimeve të kësteve të bëra në këtë kontratë.

**47.8.** Për më tepër konstatohet mospërputhje në deklaratimet e bëra me deklaratën noteriale të datës 5.11.2019, pasi në të referohet fakti se katër njësitë janë blerë me vlerë 105,000 euro, ndërkohë që sipas vetëdeklarimeve të subjektit janë blerë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., katër njësi shërbimi, njëra me çmimin 7,500,000 lekë, dhe 3 të tjerat me çmim total prej 105,000 euro.

**47.9.** Në vijim të hetimeve të kryera për këto pasuri, Komisioni i kërkoi informacion<sup>49</sup> të detajuar shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., lidhur me objektin e ndërtuar prej saj, pronotimin, pagesën e çmimit si edhe mbi mënyrën e dorëzimit të tri njësive objekt vlerësimi. Por, rezultoi se kjo shoqëri<sup>50</sup> nuk informoi dhe nuk depozitoi dokumentacion provues në Komision për momentin e kolaudimit të objektit dhe për momentin dhe mënyrën e dorëzimit të tri njësive të shërbimit, subjektit të rivlerësimit. Nuk u dërgua informacion as mbi mënyrën dhe periudhën e likuidimit të çmimit për blerjen e këtyre njësive, dhe as për faktin nëse nga porositësi, z. Ken Dhima, janë kryer punime shtesë mbi to.

**47.10.** Gjithashtu, nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti lidhur me këto pasuri (tri njësitë e shërbimit), nuk rezulton që të jetë paraqitur dokument ligjor provues, i cili në përmbushje të përcaktimeve të bëra në kontratën e prenotimit të datës 16.7.2015 të konstatojë faktin e dakortësisë së palëve për dorëzimin e tre ambienteve të shërbimit në gjendje karabina, dhe as procesverbal dorëzimi të këtyre njësive. Rezulton se subjekti nuk ka deklaruar investime të kryera mbi këto tri njësi. Ndërkohë, nga fotot e dërguara nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., duket se për të trija njësitë janë kryer/përfunduar punimet e plota, përfshirë dhe rifiniturat.

**47.11.** Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se nuk provohen pretendimet e subjektit se këto tri njësi janë marrë në dorëzim karabina dhe se çmimi total i paguar për blerjen e tyre është në shumën 105,000 euro. Si rrjedhojë, në analizën financiare, Komisioni ka reflektuar si çmim për këto pasuri shumën 246,429 euro<sup>51</sup>.

**47.12.** Në referim të kontratës së prenotimit të datës 16.7.2015, Komisioni më sipër kreu analizën e treguesve financiarë për verifikimin e mundësisë së kryerjes së pagesës së kështit të parë (në shumën prej 50,000 euro) për blerjen e pasurive objekt vlerësimi, (tabela nr. 3).

**47.13.** Bazuar në kontratën e sipërcituar, gjatë vitit 2016, subjekti ka pasur detyrim të shlyente shumën 100,000 euro, e konkretisht këstin e dytë në shumën 50,000 euro brenda muajit mars 2016 dhe këstin e tretë në shumën 50,000 euro brenda muajit nëntor 2016.

**47.14.** Në mungesë të evidencave të sakta për datat e kryerjes së këtyre pagesave (kështit të dytë dhe të tretë), si edhe në konsideratë të faktit se për vitin 2016 u konstatua pagesa e kryer në favor të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., në shumën 7,000,000 lekë – me burim fondet e përfituara nga kredia në “OTP Bank”- Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë të vitit 2016, me qëllim verifikimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për kryerjen e pagesës në shumën prej 100,000 euro (kësti 2 + kësti 3) për shlyerjen e çmimit të blerjes së pasurive objekt vlerësimi, të pasqyruar në tabelën si më poshtë:

<sup>49</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 27.5.2021.

<sup>50</sup> Dokumentacioni i depozituar nga kjo shoqëri – protokolluar në KPK me nr. \*\*\* prot., datë 15.6.2021.

<sup>51</sup> Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit për të dhënë shpjegimet përfundimtare dhe depozituar prova për të kundërshtuar rezultatin e hetimit administrativ. Subjekti nuk dërgoi prapësimet e tij, pra, nuk dha shpjegime dhe nuk depozitoi prova të reja të mundshme për të kundërshtuar qëndrimin e mbajtur nga Komisioni lidhur me këtë çështje.

**Tabela nr. 4.**

Analiza financiare, viti 2016	Vlerat në lekë
<b>A) Pasuri</b>	<b>-1, 421, 614</b>
Ndryshim likuiditeti	-1, 421, 614
<b>B) Detyrime</b>	<b>21, 000, 000</b>
Kredi tek "OTP Bank" (Ish- Societe Generale)	21, 000, 000
<b>C) Pasuri neto (A-B)</b>	<b>-22, 421, 614</b>
<b>D) Të ardhura</b>	<b>4, 656, 906</b>
Të ardhura nga paga, subjekti i rivlerësimit	1, 071, 401
Të ardhura nga paga e bashkëshortes	1, 078, 005
Të ardhura nga qiraja e njësisë së shërbimit, rruga "****".	1, 759, 500
Të ardhura nga qiraja e ambjentit për Postën Shqiptare, rruga "****"	748, 000
<b>E) Shpenzime</b>	<b>30, 599, 017</b>
Shpenzime jetike	940, 368
Shpenzime për kredinë tek "OTP Bank", disbursuar datë 18.5.2016	1, 155, 000
Shpenzime për pagesën e këstit të dytë dhe të tretë, për preonitimin e pasurive nga shoqëria "****" sh.p.k., në shumën 100,000 euro.	13, 527, 000
Shpenzime për udhëtime jashtë vendit	476, 150
Shpenzime për shlyerje huaje ndaj palëve të treta Sh dhe M.Ç (03.06.2016)	14, 000, 000
Shpenzime për arsimin e vajzës	500, 499
<b>Balanca e fondeve (D-C-E)</b>	<b>-3, 520, 498</b>

**47.15.** Sa më sipër rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht pagesën e këstit të dytë dhe të tretë për blerjen e pasurive objekt vlerësimi.

**47.16.** Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektivit për të dhënë argumentat/shpjegimet dhe provat e tij në lidhje me konstatimin e mësipërm. Por, rezulton se subjekti nuk dërgoi prapësimet e tij, pra, nuk paraqiti shpjegime dhe nuk depozitoi prova për të kundërshtuar rezultatin e hetimit.

**47.17.** Si përfundim, trupi gjykues i qëndron konstatimit dhe rezultatit fillestar se subjekti rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pagesën e këstit të dytë dhe të tretë për likuidimin e çmimit të pasurive objekt vlerësimi, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa "b" të ligjit nr. 84/2016.

**47.18.** Në vijim, bazuar në kontratën e prenotimit të pasurive objekt vlerësimi, subjekti i rivlerësimit ka patur detyrimin që gjatë vitit 2017 të paguajë shumën e mbetur prej 96,429 euro, e konkretisht këstin e katërt në shumën prej 50,000 euro brenda muajit prill 2017, dhe këstin e pestë dhe të fundit në shumën prej 46,429 euro, brenda muajit gusht 2017.

**47.19.** Por, Komisioni evidentoi se në datë 12.1.2018 nga llogaria personale e subjektivit rivlerësimit në BKT, është transfeluar në favor të shoqërisë "\*\*\*\*" sh.p.k., shuma prej 55,000 euro, me përshkrimin "*pagesë kësti sipas kontratës \*\*\* rep \*\*\* kol datë 16.7.2015*", me burim të ardhurat nga shitja e njësisë së shërbimit të ndodhur në rrugën "\*\*\*\*".

**47.20.** Sa më sipër, si edhe në mungesë të evidencave të sakta për kronologjinë e kryerjes së pagesave në favor të shoqërisë "\*\*\*\*" sh.p.k., duket se përgjatë vitit 2017 subjekti ka shlyer shumën prej 41,429 euro (diferenca mes shumës së përcaktuar në kontratë për tu shlyer gjatë vitit 2017 dhe shumës së evidentuar si të shlyer me transfertë bankare në datën 12.1.2018).

**47.21.** Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë të vitit 2017, me qëllim verifikimin e mundësisë financiare të subjektivit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për kryerjen e pagesës



në shumën 41,429 euro për shlyerjen e çmimit të blerjes së pasurive objekt vlerësimi, të pasqyruar në tabelën si më poshtë:

**Tabela nr. 5.**

Analiza financiare, viti 2017	Vlerat në lekë
<b>A) Pasuri</b>	<b>-1, 623, 028</b>
Ndryshim likuiditeti	-1, 623, 028
<b>B) Detyrime</b>	<b>0</b>
<b>C) Pasuri neto (A-B)</b>	<b>-1, 623, 028</b>
<b>D) Të ardhura</b>	<b>3, 189, 217</b>
Të ardhura nga paga, subjekti i rivlerësimit	1, 098, 302
Të ardhura nga paga e bashkëshortes	1, 128, 290
Të ardhura nga qiraja e dyqanit, në rrugën “****”, Tiranë	146, 625
Të ardhura nga qiraja e ambjentit për Postën Shqiptare, në rrugën “****”, Tiranë	816, 000
<b>E) Shpenzime</b>	<b>9, 563, 478</b>
Shpenzime jetike	846, 331
Shpenzime për kreditë tek OTP Bank, disbursuar datë 18.5.2016	2, 507, 000
Shpenzime për pagesë e një pjesë të çmimi në favor të shoqërisë “****” sh.p.k., për prenotimin e tre pasurive objekt vlerësimi.	5, 534, 576
Shpenzime për udhëtime jashtë vendit	675, 571
<b>Balanca e fondeve (D-C-E)</b>	<b>- 4, 751, 233</b>

**47.22.** Sa më sipër rezulton se, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht pagesën e kryer gjatë vitit 2017 për blerjen e pasurive objekt vlerësimi.

**47.23.** Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit për të dhënë argumentat/shpjegimet dhe provat e tij në lidhje me konstatimin e mësipërm. Por, rezulton se subjekti nuk dërgoi prapësimet e tij, pra, nuk paraqiti shpjegime dhe nuk depozitoi prova për të kundërshtuar rezultatin e hetimit.

**47.24.** Si përfundim, trupi gjykues i qëndron konstatimit dhe rezultatit fillestar se subjekti rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pagesën e kryer gjatë vitit 2017 (pjesë e kështit të katërt) për likuidimin e çmimit të pasurive objekt vlerësimi, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” të ligjit nr. 84/2016.

**47.25.** Gjithashtu, Komisioni konstaton se gjatë viteve 2016 – 2017 janë depozituar *cash* nga persona të tretë vlera monetare për shlyerjen e kësteve të kredisë së marrë nga subjekti rivlerësimit dhe personi i lidhur në OTP Bank, e konkretisht: (1) nga shtetasja M.C janë kryer 15 depozitime, në vlerën totale 2,475,000 lekë; (2) nga shtetasi F.M është kryer një depozitim në shtator të vitit 2016, në vlerën 165,000 lekë; (3) nga shtetasja E.M është kryer një depozitim në tetor të vitit 2016, në vlerën 165,000 lekë; (4) nga shtetasi H.M është kryer një depozitim në janar të vitit 2017, në vlerën 165,000 lekë; (5) dhe nga shtetasi A.Ç është kryer një depozitim në gusht të vitit 201, në vlerën 527,000 lekë.

**47.26.** Sa më sipër, në kushtet kur fondet e depozituara apo të transferuara nga shtetasit e sipërcituar kanë shërbyer për shlyerjen e kredisë së marrë nga subjekti dhe bashkëshortja e tij, në referim të pikës 14, të nenit 3 si dhe pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, rezulton se shtetasit M.C, E.M, F.M, H.M, dhe A.C bëjnë pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, në këtë rast të provojnë ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të cilat kanë shërbyer për krijimin e shumave të depozituara apo të transferuara në llogarinë bankare të personit të lidhur.

**47.27.** Më dërgimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektivit, për sa vijon:

- i. Të identifikojë me gjeneralitete të plota shtetasit të cilët kanë kryer këto depozitime në llogarinë e përbashkët me bashkëshorten e tij në “OTP Bank”, dhe të deklarojë mbi marrëdhënien e tij apo të personit të lidhur me to;
- ii. Të deklarojë, nëse ai apo bashkëshortja e tij kanë gjykuar çështje gjyqësore civile/penale, me palë ndërgjygjëse/kallëzues/të kallëzuar/të pandehur/të dëmtuar etj., shtetasit e evidentuar si më sipër;
- iii. Të deklarojë nëse këto depozitime/transferta përfaqësojnë dhurime apo hua, dhe nëse po, përse nuk janë deklaruar, dhe a i janë kthyer këto vlera monetare këtyre shtetasve;
- iv. Personat e sipërcituar të deklarojnë mbi këto depozitime/transferta, qëllimin e tyre dhe marrëdhënien mbi bazën e së cilës ato janë kryer;
- v. Nëse këto fonde përfaqësojnë dhurime apo hua, të depozitohet dokumentacioni justifikues ligjor për të ardhurat e personave të tjerë të lidhur të cilat kanë shërbyer si burim krijimi për shumat e depozituara apo të transferuara në këtë llogari.

**47.28.** Në kushtet kur, subjekti nuk paraqiti prapësimet e tij lidhur me rezultatet e hetimit administrativ, si edhe në konsideratë të faktit se ai nuk ka deklaruar ndër vite hua apo dhurime që lidhen me këto depozitime apo transferta, shtetasit e sipërcituar nuk kanë konfirmuar marrëdhënie huaje apo dhurimi si edhe nuk është depozituar dokumentacioni justifikues ligjor për të ardhurat e tyre (sipas parashikimit të bërë në nenin 32/4 të ligjit nr. 84/2016), trupi gjykues vlerëson se në analizën financiare e gjithë vlera e kredisë së shlyer (principal + interes) sipas informacionit të marrë nga “OTP Bank”, të reflektohet si shumë e paguar nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur.

**48. Pasuria e llojit “apartament banimi”,** me sipërfaqe 51.65 m<sup>2</sup>, ndodhur në \*\*\*, viti i krijimit 1994, vlera e papërcaktuar. Deklaron se zotëron 1/5 pjesë.

**48.1. Burimi i krijimit të kësaj pasurie:** subjekti deklaroi se kjo pasuri është përfituar si rezultat i ligjit nr. \*\*\*, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”, për të cilën është nënshkruar kontrata e shitjes nr. \*\*\* rep., \*\*\* kol., viti 7.8.1994, përpara noterit R.S.

**48.2.** Trupi gjykues, pasi vlerësoi rrethanat dhe faktet mbi këtë pasuri, si dhe verifikoi dokumentacionin e administruar në dosje, vëren se në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar saktë të dhënat e kësaj pasurie dhe vlerëson se nuk ka dyshime për pjesën takuese që ai zotëron mbi të, përfituar nëpërmjet ligjit të privatizimit.

**49. Pasuri në proces legalizimi,** ku deklarues është babai i subjektivit, z. V.Dh, provuar me vetëdeklarimin datë 10.11.2006, datë në të cilën deklaroi se rezultoi edhe ai dhe bashkëshortja në përbërje familjare me babain.

**49.1.** Trupi gjykues mban të njëjtin qëndrim edhe në lidhje me pasurinë “godinë banimi 1 kat” në rrugën “\*\*\*” në proces legalizimi, ku deklarues është babai i subjektivit, z. V.Dh. Për sa rezultoi nga hetimi, objekti është ndërtuar në vitin 1992 dhe nga analiza e rrethanave dhe fakteve të mësipërme, si edhe nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje<sup>52</sup> Komisioni vëren se subjekti nuk zotëron pjesë takuese mbi këtë objekt dhe çmon se nuk ka dyshime që ai mund të ketë kontribut në krijimin e saj.

---

<sup>52</sup> Dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti pjesë e dosjes së ILDKPKI-së (Aneks \*\*\*), dhe dokumentacioni pjesë e hetimit të bërë nga ILDKPKI për këtë pasuri (Aneks \*\*\*).

## Çështje të tjera

### 50. Pasuria e llojit “apartament”, me sipërfaqe 109 m<sup>2</sup>, e ndodhur në \*\*\*

**50.1.** Në raportin e ILDKPKI-së, bazuar në informacionin e marrë nga agjensitë ligjzbatuese, është konstatuar fakti se në datën 3.2.2011, subjekti i rivlerësimit ka porositur nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., pasurinë e mësipërme, për çmimin 60,000 euro.

**50.2.** Komisioni konstaton se në kundërshtim me parashikimet e bëra në germën “a”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, subjekti nuk e ka deklaruar këtë pasuri të paluajtshme, të drejtat reale mbi të, as në deklaratat e interesave privatë/periodikë vjetorë dhe as në deklaratën “Vetting”, të dorëzuara në ILDKPKI.

**50.3.** Në përgjigje të kërkesës së dërguar nga Komisioni<sup>53</sup>, ILDKPKI-ja<sup>54</sup> ka vënë në dispozicion dokumentacionin e administruar ndër vite në dosjen e subjektit të rivlerësimit, z. Ken Dhima.

**50.4.** Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar bashkëlidhur shkresës “kthim përgjigje”, konstatohet dokumenti me titull “Observacion”, drejtuar Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, me shënimin me shkrim të lirë dore “\*\*\*\*”, në referim të së cilit ndër të tjera rezulton se subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se *midis tij dhe shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., është lidhur një kontratë sipërmarrje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 3.2.2011, e cila është lidhur në kushtet e fiktivitetit, sepse qëllimi i kësaj kontrate ishte prenotimi i një hyrje të ndërtuar nga shoqëria në fjalë, në Shëngjin, për vëllain e tij E.Dh, i cili në atë kohë ndodhej në Greqi. Kjo kontratë sipërmarrje nuk është deklaruar për vitin 2011, sepse është një veprim juridik i pavlefshëm i lidhur mes tij dhe shoqërisë në fjalë. Vullneti real për lidhjen e kontratës së sipërmarrjes midis vëllait të tij dhe shoqërisë është shprehur edhe nga vetë shoqëria ndërtuese dhe prej tij, që kanë revokuar kontratën e sipërmarrjes. Ai, si deklarues nuk gëzon asnjë të drejtë pronësie lidhur me objektin në fjalë.*

**50.5.** Në dosjen e ILDKPKI-së<sup>55</sup> lidhur me këtë marrëdhënie është administruar dokumentacioni si vijon: (i) kontratë sipërmarrje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 3.2.2011, lidhur midis subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., (ii) deklaratë noteriale “Për prishje kontrate” nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 19.10.2013; (iii) kontratë sipërmarrje për ndërtim apartamenti me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 19.10.2013, lidhur midis shtetasit E.Dh dhe shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.

**50.6.** Rezulton se me kontratën e sipërmarrjes<sup>56</sup> të datës 3.2.2011, subjekti i rivlerësimit ka porositur nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., pasurinë e llojit “apartament banimi” me sipërfaqe të përgjithshme 109 m<sup>2</sup>, në objektin që do ndërtonte kjo shoqëri, në Shëngjin, Lezhë, për çmimin 60,000 euro. Në këtë kontratë është referuar plani i pagesave si vijon: (i) kësti i parë në shumën 50,000 euro është likuiduar paraprakisht; dhe (ii) diferenca e mbetur do të paguhet me përfundimin e objektit.

**50.7.** I pyetur nga Komisioni lidhur me këtë pasuri<sup>57</sup>, mosdeklarimin e saj, si edhe për burimin e të ardhurave të cilat kanë shërbyer për pagesën e kështit të parë në shumën prej 50,000 euro, subjekti i rivlerësimit deklaroi se, *[...]Kësaj pyetjeje unë i jam përgjigjur në deklarinimin përfundimtar[...].* Por, nuk referon se për cilin deklarinim e ka fjalën.

<sup>53</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 29.1.2021.

<sup>54</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 16.3.2021.

<sup>55</sup> Dokumentacioni i ndodhur Aneks \*\*\* , në dosjen e ILDKPKI.

<sup>56</sup> Kontratë sipërmarrje me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 3.2.2011, redaktuar nga noteri publik, z. V.M.

<sup>57</sup> Pyetja nr. 15 e pyetësorit nr. 2.

**50.8.** Me anë të deklaratës noteriale<sup>58</sup> “Për prishje kontrate” të datës 19.10.2013 që i referohet prishjes së kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol, për pasurinë e mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: **a)** kontrata është lidhur formalisht prej tij, pasi vëllai i tij ndodhej në Greqi dhe ishte në pamundësi për të nënshkruar këtë kontratë; **b)** të gjitha të drejtat e fituara nga Ken Dhima, pas revokimit të kontratës i kalojnë vëllait E.Dh dhe se subjekti heq dorë nga pronësia e pasurisë; **c)** nga ana e shoqërisë do të njihen të gjitha pagesat e kryera deri në këtë moment dhe nuk ndryshon asgjë nga kushtet e kontratës me Ken Dhima me kontratën e E.Dh; **c)** me kthimin në Shqipëri, kontrata me firmën ndërtuese do të lidhet me vëllain e tij.

**50.9.** Shoqëria “\*\*\*” ka deklaruar se: **a)** heq dorë nga kontrata e parë dhe se pagesat e kryera i kalon për llogari të kontratës që do të lidhet me z. E.Dh; **b)** në lidhje me pagesat deklarohet se është paguar kësti i parë prej 50,000 eurosh dhe se diferenca do të paguhet me përfundimin e objektit.

**50.10.** I pyetur në vijim nga Komisioni<sup>59</sup> për rrethana të tjera që lidhen me këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit ndër të tjera ka deklaruar se, ai personalisht nuk ka bërë asnjë pagesë dhe nuk i është kthyer asnjë pagesë nga vëllai i tij, dhe se sqarimin për këtë çështje e ka bërë tek ILDKPKI në momentin e duhur.

**50.11.** Nga verifikimi i kryer në sistemin *TIMS*, rezultoi se shtetasi E.Dh ka qenë në territorin shqiptar në datën e nënshkrimit të kontratës sipërmarrjes mes subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., (datë 3.2.2011). Rezulton sipas të dhënave të sistemit *TIMS* se dalja e parë këtij shtetasi jashtë territorit shqiptar është në datën 25.5.2011 (kjo sa i takon periudhës për të cilën sistemi *TIMS* disponon të dhëna).

**50.12.** Për më tepër, Komisioni evidentoi faktin se në datën 4.3.2011, z. E.Dh ka depozituar cash në llogarinë e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit në Raiffeisen Bank, shumën prej 128,400 lekë, me përshkrimin “*E.Dh derdh këst kredie*”.

**50.13.** Referuar të dhënave të mësipërme, rezulton se nuk qëndrojnë pretendimet e subjektit se e ka prenotuar pasurinë objekt vlerësimi në emër të vëllait të tij, për shkak se ai ndodhej jashtë shtetit. Subjekti nuk dha shpjegime dhe nuk paraqiti dokumentacion provues lidhur me burimin e të ardhurave të cilat kanë shërbyer për kryerjen e pagesës së këstit të parë për porositjen e kësaj pasurie në datën 3.2.2011.

**50.14.** Nga analiza e kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri, në kuptim të ligjit për deklarimin e pasurive dhe ligjit për konfliktin e interesave, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011 porositjen e kësaj pasurie dhe të drejtat reale mbi të, pagesën e kryer gjatë këtij viti (si shpenzim), burimin e të ardhurave të cilat kanë shërbyer për pagesën e kryer, si edhe subjektin me të cilin ka hyrë në marrëdhënie kontraktuale, duke u munduar të fshehë këtë pasuri dhe interesat privatë që e lidhin me të.

**50.15.** Trupi gjykues arrin në përfundimin se apartamenti në Shëngjin është pasuri e porositur dhe e paguar nga subjekti i rivlerësimit, me qëllim përdorimin, disponimin dhe gëzimin e plotë nga ana e tij, por se në vijim ka transferuar të drejtat e kësaj pasurie tek i vëllai, z. E.Dh, në dukje me qëllim shmangien e kontrollit dhe verifikimit të ligjshmërisë së burimeve, të cilat kanë shërbyer për pagesën/pagesat e kryer/a për likuidimin e çmimit të blerjes.

**50.16.** Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit për të dhënë argumente/shpjegimet dhe provat e tij në lidhje me konstatimin e mësipërm. Por, rezulton se subjekti nuk dërgoi prapësimet e tij, pra nuk paraqiti shpjegime dhe nuk depozitoi prova për të kundërshtuar rezultatin e hetimit.

---

<sup>58</sup> Deklaratë noteriale “Për prishje kontrate” nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 19.10.2013, redaktuar nga noteri publik, z. V.M.

<sup>59</sup> Pyetja nr. 15.1 e pyetësorit nr. 2.

**50.17.** Sa më sipër, në vlerësim tërësor të rrethanave dhe fakteve të mësipërme, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje të pasurisë dhe, si rrjedhojë, ai gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit 84/2016.

**50.18.** Në këtë kuptim, në kushtet kur u arrit në përfundimin se kjo pasuri është porositur dhe është paguar nga subjekti i rivlerësimit (pasuri e fshehur), me qëllim kryerjen e një hetimi shterues, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë për të verifikuar mundësinë e subjektivitetit dhe personave të lidhur me të, për kryerjen në datën 3.2.2011 të pagesës së kësaj pasurie (sipas parashikimit të bërë në kontratën e sipërmarrjes), të pasqyruar në tabelën si më poshtë vijon:

**Tabela nr. 6.**

<b>Analiza financiare, periudha 1.1.2011 - 3. 2.2011</b>	<b>Vlera në lekë</b>
<b>A) PASURI</b>	<b>7, 072, 936</b>
Apartamenti në Shëngjin, paguar kësti i parë 50,000 euro (datë 3.2.2011)	6, 915, 000
Ndryshim likuiditeti	157, 936
<b>B) Detyrime</b>	<b>0</b>
<b>C) Pasuri neto (A-B)</b>	<b>7, 072, 936</b>
<b>D) Të ardhura</b>	<b>295, 828</b>
Të ardhura nga paga, subjekti i rivlerësimit	158, 606
Të ardhura nga paga e bashkëshortes	137, 222
<b>E) Shpenzime</b>	<b>200, 662</b>
Shpenzime jetike	38, 179
Shpenzime për kreditë pranë “Tirana Bank”, disbursuar në datën 22.8.2005	34,160
Shpenzime për kreditë tek “Raiffeisen Bank”, disbursuar në datën 8.10.2010	128, 323
Shpenzime për udhëtime jashtë vendit	0
<b>Analiza financiare (D-C-E)</b>	<b>- 6, 977, 770</b>

**50.19.** Sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar pagesën e kësaj pasurie, duke u gjendur edhe në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” të ligjit 84/2016.

**51. Pasuria e llojit “njësi tregtare” me sipërfaqe 124 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “\*\*\*\*” Tiranë, me vlerë 150,000 euro**

**51.1.** Nga verifikimi i kryer konstatohet se në DPV/2010, në seksionin e ndryshimet e interesave privatë pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme, subjekti ka deklaruar: kredi tek “Raiffeisen Bank”, si garantues, shuma 10,000,000 lekë. Deklaruar pjesa në përqindje, 50 %. Por, Komisioni vëren se subjekti nuk ka deklaruar qëllimin e marrjes së kësaj kredie dhe destinacionin e vlerave monetare të përfituara prej saj.

**51.2.** Ndërsa në DPV/2011 ka deklaruar në seksionin e ndryshimet e interesave privatë/ pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme: Pagesë kredie si dorëzanës, afërsisht 15 milionë lekë të vjetra. Deklaruar pjesa në përqindje, 50 %. Gjithashtu, në seksionin e detyrimeve financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë ka deklaruar pagesë kredie te “Raiffeisen Bank”, afërsisht shumën prej 15 milionë lekë të vjetra megjithë interesa dhe gjendjen e detyrimit të mbetur (principali), afërsisht 95 milionë lekë të vjetra. Rezulton se në DPV/2012 dhe DPV/2013 subjekti nuk ka deklaruar të dhëna lidhur me këtë kredi.

**51.3.** Ndërsa në DPV/2014, në seksionin e detyrimeve financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë subjekti ka deklaruar gjendje detyrimi ndaj “Raiffeisen Bank” 5,706,207 lekë, e cila në DPV/2015 deklarohet e shlyer nga shtetasi A.Ç, për të cilin ishte marrë kredia, duke u çliruar nga dorëzania subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja.

**51.4.** Nga hetimi i dokumentacionit në ILDKPKI për këtë marrëdhënie, midis të tjerash ka rezultuar<sup>60</sup> se midis shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. në cilësinë e palës së porositur, shtetasit A.Ç në cilësinë e porositësit dhe subjektit të rivlerësimit në cilësinë e garantuesit të kontratës janë lidhur 2 kontrata porosie për pasurinë e llojit “dyqan” me sipërfaqe 124 m<sup>2</sup>, në objektin që kjo shoqëri po/do ndërtonte në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë: kontrata e porosisë së datës 5.8.2009, për çmimin prej 220,000 euro dhe kontrata e porosisë së datës 10.8.2009 në shumën 150,000 euro. Rezulton me mandatpagesë të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me nr. \*\*\*, datë 5.8.2009, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit ka paguar shumën prej 30,000 euro (kësti i parë), me përshkrimin “Për kontratën e dt. 5.8.2009 ndërmjet palëve”.

**51.5.** Nga analiza rezulton se kemi të bëjmë me 2 kontrata porosie për të njëtin objekt (dyqanin prej 124 m<sup>2</sup>), me të njëjtat palë, të nënshkuara në dy data të ndryshme dhe në të cilat ndryshon çmimi dhe plani i pagesave.

**51.6. Rezulton gjithashtu nga dokumentacioni kontratë kredie bankare** me “Raiffeisen Bank”, me nr. \*\*\* rep., \*\*\* kol., datë 2.10.2010, me palë kredimarrëse subjektin e rivlerësimit dhe personin e lidhur. Gjithashtu, pas kërkesës së bërë nga Komisioni<sup>61</sup>, ILDKPKI<sup>62</sup> ka dërguar dokumentacionin e administruar ndër vite në dosjen e subjektit të rivlerësimit, z. Ken Dhima. Nga verifikimi të cilit konstatohet dokumenti me titull “Sqarim”, drejtuar Inspektorëve të ILDKPKI, me shënimin me shkrim të lirë dore “\*\*\*\* Ken”, në referim të së cilit ndër të tjera rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur (bashkëshortja) kanë parashtruar se, [...] në vitin 2010 është marrë një kredi në shumën 10,000,000 lekë nga ne si dorëzanes të shtetasit A.Ç. Kjo për të paguar një ambient dyqan sipas kontratës së sipërmarrjes mes tij dhe shoqërisë \*\*\*. Duam tju theksojmë se kjo kredi është marrë në emrin tonë për faktin se vetë subjekti A.Ç (përkatesisht kunati dhe vëllai) nuk mund të merrte kredi, sepse nuk plotësonte kushtet. Të gjitha pagesat e kësteve bëhen rregullisht nga ana e shtetasit A.Ç, në disa raste kur shtetasi A.Ç ka vonuar një apo dy ditë pagesën, ajo është mbajtur nga llogaria e K.Ç, e cila është rikthyer menjëherë nga A.Ç. Gjithashtu në 2 prill 2012 është bërë një parapagesë e një pjese të principalit të kredisë nga A.Ç në shumën 2,400,000 lekë. Po e bëjmë këtë sqarim sepse nuk e kemi pasqyruar në deklarinë e pasurisë për shkak të formatit të saj [...].

**51.7.** Shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., përfaqësuar nga administratori z.P.K, me shkresën e datës 3.1.2012 drejtuar ILDKPKI-së<sup>63</sup>, se e vetmja marrëveshja kontraktuale që ata kanë është kontrata e porosisë e datës 10.8.2009 me z. A.Ç për pasurinë objekt vlerësimi në shumën 150,000 euro. Z. Ken Dhima është quajtur garantues i kontratës për shkak të pasigurive që ka shfaqur në pagesë kunati i tij, z. Ç. Në vijim të likuidimit të detyrimeve z. A.Ç ka paguar në rrugë bankare shumat: (i) 2,000,000 lekë në datën 30.10.2009; (ii) 5,000 euro në datën 7.1.2010; (iii) 1,000,000 lekë në datën 5.5.2010.

**51.8.** Edhe pse Komisioni ka kërkuar nga subjekti dokumentacion justifikues ligjor lidhur me pagesat e pretenduara si të kryera nga shtetasi A.Ç, siç është theksuar edhe më parë, subjekti nuk paraqiti prapësime dhe as prova të mundshme për marrëdhënien e shtetasit A.Ç me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k.

**51.9.** Në vijim, nëpërmjet shkresës së sipërcituar administratori dhe ortaku i vetëm i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., ka informuar se meqënëse filluan të krijojnë vonesa në pagesat respektive të kësteve ato vendosën kolateral një ambient të tyrin, praktikë që e kanë përdorur edhe herë tjetër për blerës të besuar. Në bazë të këtij kolaterali u mor prej tyre kredia bankare sipas kontratës 2.10.2010 me znj K.Ç dhe Ken Dhima, në vlerën 10,500,000 lekë, nga e cila u kaluan me transfertë bankare në favor të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., në “Raiffeisen Bank”, shuma 7,800,000 lekë, datë 11.10.2010, sipas përshkrimit \*\*\*. Shuma e likuiduar deri më sot (datë 3.1.2012)

<sup>60</sup> Dokumentacioni ndodhur Aneks \*\*\*, në dosjen e ILDKPKI.

<sup>61</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 27.1.0021.

<sup>62</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 16.3.2021.

<sup>63</sup> Protokolluar në ILDKPKI nr. \*\*\* prot., datë 5.1.2012.

prej tyre është 10,800,000 lekë (rreth 85,000 euro), duke pasur një detyrim ndaj shoqërisë prej 65,000 euro.

**51.10.** Trupi gjykues vëren se në këtë shkresë është referuar një plan tjetër pagesash nga ai i përcaktuar në kontratën/kontratat e sipërmarrjes dhe se ajo paraqet të dhëna kontradiktore në përmbajtjen e saj, pasi nga njëra anë janë referuar 3 pagesa të kryera në rrugë bankare nga shtetasi A.Ç në total shumën prej 3,000,000 lekë dhe 5,000 euro dhe një pagesë nga llogaria e kredisë së subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur në shumën 7,800,000 lekë, nga ana tjetër thuhet se pagesa totale e kryer është 10,800,000 lekë. Gjithashtu, nuk është referuar pagesa e kështit të parë në datën 5.8.2009 në shumën prej 30,000 euro, e cila sipas mandatpagesës së sipërcituar është paguar nga subjekti i rivlerësimit.

**51.11.** Në vlerësim të rrethanave dhe fakteve të mësipërme, bazuar në mandatpagesën e datës 5.8.2009 si edhe në kontratën e sipërmarrjes për këtë pasuri, Komisioni kreu analizën financiare për të verifikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, për kryerjen në datën 5.8.2009 të pagesës së kështit të parë për porositjen e pasurisë objekt vlerësimi.

**Tabela nr. 7.**

<b>Analiza financiare për periudhën 1.1.2009 – 5.8.2009</b>	<b>Vlerat në lekë</b>
<b>A) Pasuri</b>	<b>4, 013, 918</b>
Njësi tregtare me sipërfaqe 124 m <sup>2</sup> , ndodhur në rrugën “****”, paguar në datën 5.8.2009 kështit të parë 30,000 euro.	4, 115, 100
Ndryshim likuiditeti	-101, 182
<b>B) Detyrime</b>	<b>0</b>
<b>C) Pasuri neto (A-B)</b>	<b>4, 013, 918</b>
<b>D) Të ardhura</b>	<b>1, 435, 087</b>
Të ardhura nga paga, SR	552 253
Të ardhura nga mësimdhënia në universitetin “Kristal”, subjekti i rivlerësimit	266 040
Të ardhura nga paga e bashkëshortes	530 394
Të ardhura nga mësimdhënia në universitetin “Kristal” (bashkëshortja)	86, 400
<b>E) Shpenzime</b>	<b>457, 741</b>
Shpenzime jetike	241, 424
Shpenzime për kreditë pranë “Tirana Bank” disbursuar në datën 22.8.2005	216, 317
<b>Balanca e fondeve (D-C-E)</b>	<b>-3, 036, 573</b>

**51.12.** Sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar pagesën e kështit të parë për prenotimin e kësaj pasurie (qoftë edhe në përmbushje të detyrimit si garantues i kontratës).

**51.13.** Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit për të dhënë argumentet/shpjegimet dhe provat e tij në lidhje me konstatimin e mësipërm, por, rezultoi se subjekti nuk dërgoi prapësimet e tij, pra, nuk paraqiti shpjegime dhe nuk depozitoi prova për të kundërshtuar rezultatin e hetimit.

**51.14.** Si përfundim, trupi gjykues i qëndron konstatimit dhe rezultatit fillestar se subjekti rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pagesën e kështit të parë për likuidimin e çmimit për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi, qoftë edhe në përmbushje të detyrimit si garantues i kontratës, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” të ligjit nr. 84/2016.

“Raiffeisen Bank”<sup>64</sup>, konfirmon se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur një kredi në shumën 10,500,000 lekë të marrë në datën 8.6.2010 dhe të mbyllur në datën 15.5.2015.

<sup>64</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 25.5.2021.

**51.15.** Nga verifikimi i këtij informacioni rezulton se në datën 2.10.2010, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, znj. K.Ç, në cilësinë e bashkëkredimarrësve, kanë nënshkruar kontratën e kredisë bankare dhe hipotekore<sup>65</sup> me “Raiffeisen Bank”, duke përfituar kredinë konsumatore në shumën prej 10,500,000 lekësh, me afat shlyerje 15-vjeçar.

**51.16.** Ndërsa, në cilësinë e dorëzanësve hipotekore në këtë kredi janë shtetasit P.K (përfaqësues ligjor dhe ortak i vetëm i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.) dhe M.K dhe si kolateral për marrjen e kësaj kredie është vendosur pasuria e llojit “apartament” me sipërfaqe 134 m<sup>2</sup> e ndodhur në rrugën “\*\*\*\*” në Tiranë, e regjistruar në emër të dorëzanësve.

**51.17.** Bazuar në kërkesën<sup>66</sup> e bërë nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, është ndryshuar pasuria e lënë si garanci për këtë kredi, duke u vendosur si kolateral pasuria e llojit “njësi” me sipërfaqe 123.9 m<sup>2</sup>, e ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, zona kadastrale \*\*\*, volum \*\*\*, faqe \*\*\*, me nr. pasurie \*\*\*, pasuri e cila rezulton të jetë e njëjtë me pasurinë objekt verifikimi/vlerësimi. Gjithashtu konstatohet se aplikimi i bërë për bllokimin e kësaj pasurie në hipotekë është bërë nga shtetasi A.Ç, të cilit i është konfirmuar zyrtarisht nga ZVRPP-ja Tiranë bllokimi i kësaj pasurie të paluajtshme.

**51.18.** Komisioni vëren se, megjithëse kemi të bëjmë me një kredi konsumatore, pjesë e dokumentacionit të dosjes së kësaj kredie gjendet dhe kontrata e porosisë e datës 5.8.2009, nënshkruar mes shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., (i porosituri), pala 1 dhe palës 2, A.Ç, si porositës dhe Ken Dhima garantues, për porositjen e njësisë së shërbimit me sipërfaqe prej 124 m<sup>2</sup>, për çmimin prej 220,000 euro (me plan pagesash të pasqyruar si më sipër).

**51.19.** Rezulton se në datën 8.10.2010 është disbursuar në llogarinë bankare të bashkëshortes së subjektit, znj. K.Ç, shuma prej 10,500,000 lekë, nga e cila shuma prej 500,000 lekë ka kaluar si pagesë për primin e policës së sigurimit të jetës së personit të lidhur dhe të pronës së lënë kolateral.

**51.20.** Në vijim, në datën 11.10.2010 nga kjo llogari, personi i lidhur, znj. K.Ç, transferon shumën prej 7,800,000 lekë në favor të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me përshkrimin “pagesë detyrimi”, ndërsa pjesa tjetër prej 2,198,000 lekë tërhiqet *cash* brenda së njëjtës dite.

**51.21.** Sikurse u pasqyrua më sipër, vetëm në deklaratat e interesave privatë të viteve 2010, 2011, 2014 dhe 2015 është deklaruar kjo kredi dhe shumat e shlyera gjatë këtyre viteve.

**51.22.** Nga verifikimi i dokumentacionit bankar rezulton se kjo kredi është shlyer shlyer para kohe deri në datën 15.5.2015, paguar nga llogaria e pagës së personit të lidhur në “Raiffeisen Bank”<sup>67</sup>, shuma në total përfshirë principal, interes dhe sigurime jete dhe prone, në vlerën prej 15,128,979 lekësh. Vërehet se gjatë viteve 2011 – 2015 janë depozituar *cash* dhe janë transferuar në këtë llogari nga persona të tretë vlera monetare për shlyerjen e kësteve të kredisë, e konkretisht: (1) nga shtetasi E.Dh është kryer një depozitim në vitin 2011, në vlerën prej 128,400 lekë; (2) nga shtetasi B.S janë kryer pesë depozitime gjatë viteve 2011 – 2012, në total për vlerën prej 691,000 lekë; (3) nga shtetasi F.E është kryer një depozitim në vitin 2011, në vlerën prej 309,000 lekë; (4) nga shtetasi H.B janë kryer dy depozitime gjatë vitit 2013, në total për vlerën prej 160,000 lekë, dhe (5) nga shtetasi A.Ç janë konstatuar 19 transaksione, transfertat dhe depozitime, në total për vlerën 10,968,640 lekë.

**51.23.** Gjithashtu, rezulton se disa pagesa këstesh janë mbajtur nga paga e personit të lidhur, nga llogaria e saj e kursimit, si edhe janë kryer prej saj depozitime *cash* në këtë llogari.

**51.24.** Sa më sipër, në kushtet kur fondet e depozituara apo të transferuara nga shtetasit e sipërcituar kanë shërbyer për shlyerjen e kredisë së marrë nga subjekti dhe bashkëshortja e tij,

<sup>65</sup> Kontratë kredie bankare dhe hipotekore nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 2.10.2010, redaktuar nga noteri publik, znj. M.K.

<sup>66</sup> Kërkesa e datës 19.02.2013 - pjesë e dosjes së kredisë.

<sup>67</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 25.5.2021.



bazuar në pikën 14 të nenit 3, si dhe pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, shtetasit E.Dh, B.S, F.E, A.Ç, dhe H.B bëjnë pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, në këtë rast të provojnë ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të cilat kanë shërbyer për krijimin e shumave të depozituara apo të transferuara në llogarinë bankare të personit të lidhur.

**51.25.** Më dërgimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit për të shpjeguar marrëdhënien me këta shtetas si dhe të depozitonte dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e personave të tjerë të lidhur të cilat kanë shërbyer si burim krijimi për shumat e depozituara apo të transferuara në këtë llogari.

**51.26.** Në kushtet kur subjekti nuk paraqiti prapësimet e tij lidhur me rezultatet e hetimit administrativ, si edhe duke marrë në konsideratë faktin se ai nuk ka deklaruar ndër vite hua apo dhurime që lidhen me këto depozitime apo transferta, shtetasit e sipërcituar nuk kanë konfirmuar marrëdhënie huaje apo dhurimi, si edhe nuk është depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e tyre (sipas parashikimit të bërë në nenin 32/4 të ligjit nr. 84/2016), trupi gjykues vlerëson se gjithë vlera e kredisë së shlyer (principal + interes) sipas informacionit të marrë nga “Raiffeisen Bank” të reflektohet si shumë e paguar nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur.

**52.** Në vijim të verifikimeve dhe hetimeve të kryera lidhur me këtë pasuri, Komisioni vëren se “Ujësjetllës - Kanalizime Tiranë” (UKT)<sup>68</sup>, informon se në emër të subjektit të rivlerësimit figuron kontratë furnizimi aktive me nr. \*\*\*, me datë hapje 6.4.2011, në adresën rruga “\*\*\*\*”, pallati “\*\*\*\*” sh.p.k., Tiranë<sup>69</sup>, e cila përkon me adresën e pasurisë, njësisë tregtare objekt vlerësimi, por se disponojnë vetëm një libër faturimi ku shënohen me shkrim dore disa të dhëna.

**53.** Pasi Komisioni kërkoi<sup>70</sup> dokumentacionin mbi bazën e të cilit është lidhur kjo kontratë furnizimi me ujë të pijshëm, UKT-ja<sup>71</sup> informon se për kontratën nr. \*\*\* disponon vetëm libër faturimi. Nga verifikimi i këtij dokumentacioni, për këtë kontratë është dërguar kopje e dokumentit me titull “REGJISTER KONTRAKTUESVE” (1 fletë), nga ku rezulton se janë pasqyruar me shkrim të lirë dore të dhënat si më poshtë (në rreshtin e dytë të tabelës së mëposhtme):

Nr.rend	Nr. Kontrat.	Nr. Frymëve	Adresa	Ndryshime		Nr. Frymëve	Shënime
				Emri, Mbiemri	Data		
1	***	D	Ken Dhima	Rr. “****”			Speed D2

Gjithashtu, Komisioni konstaton se në funksion të verifikimit të kësaj pasurie, ILDKPKI i ka kërkuar z. A.Ç, që në cilësinë e personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit, të plotësojë deklaratën e interesavë privatë me kërkesë. Rezulton se, fillimisht, z. A.Ç, ka refuzuar plotësimin e kësaj deklarate, dhe si rrjedhojë në datën 7.2.2013, Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së ka nxjerrë vendimin<sup>72</sup> për vendosjen e gjobës për mosdeklarim të interesave private me kërkesë, vendim i përcjellë me shkresën<sup>73</sup> e datës 11.2.2013.

**53.1.** Rezulton se pas dorëzimit të deklaratës<sup>74</sup> z. Ç ka deklaruar dyqan 130 m<sup>2</sup>, duke konfirmuar kredinë e marrë në “Raiffeisen Bank”, me dorëzanës z. Ken Dhima dhe K.Ç, *shuma*

<sup>68</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 3.4.2020.

<sup>69</sup> Referuar të dhënave nga SMI (Sistemi i Menaxhimit të Informacioit) të UKT.

<sup>70</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 31.5.2021.

<sup>71</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 18.6.2021.

<sup>72</sup> Vendim nr. \*\*\*, datë 7.2.2013, ndodhur Ankes \*\*\*, në dosjen e ILDKPKI.

<sup>73</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2013, ndodhur Ankes \*\*\*, në dosjen e ILDKPKI.

<sup>74</sup> Referuar vërtetimit kjo deklaratë është dorëzuar nga shtetasi F.E. Vërtetimi I dorëzimit dhe deklarata, ndodhur Aneks \*\*\*, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së.

*e detyrimit të mbetur 8,000,000 lekë* si dhe detyrim financiar të shoqëria “\*\*\*\*”. Gjithashtu ka deklaruar se subjekti i vlerësimit dhe bashkëshortja *garant të kontratës së sipërmarrjes dhe kanë marrë një kredi për llogari të tij*. Komisioni vëren se z. A.Ç nuk ka deklaruar asnjë të dhënë për mbi kontratën me shoqërinë “\*\*\*\*”.

**53.2.** Gjithashtu konstatohet se, z. A.Ç ka referuar të dhëna jo të sakta lidhur me sipërfaqen e kësaj pasurie, si edhe ka deklaruar se edhe K.Ç është garante e kontratës së sipërmarrjes, fakt i cili nuk rezulton nga verifikimi i kontratës/kontratave të porosisë

**54. Sa më sipër, nga analiza e të gjithë provave të administruara në dosje, si edhe rrethanave, fakteve dhe indicieve të konstatuara për pasurinë objekt vlerësimi, si:**

- i. Mandatpagesa e datës 5.8.2009, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit ka paguar shumën 30,000 euro në favor të shoqërisë ndërtuese;
- ii. Mosevidentimi nga shoqëria ndërtuese i pagesës së kryer në datë 5.8.2009 nga subjekti i rivlerësimit, dhe dërgimi i informacionit kontradiktor lidhur me pagesat e kryera në funksion të kontratës së porosisë;
- iii. Ekzistenca e dy kontratave porosie me të njëjtët palë, të njëjtin objekt, por të cilat ndryshojnë vetëm tek çmimi, dhe si rrjedhojë dhe te plani i pagesave;
- iv. Shfaqja e subjektit të rivlerësimit si garantues i kontratës së porosisë;
- v. Deklarimi i subjektit mbi miqësinë e tij me përfaqësuesin ligjor dhe ortakut të vetëm të shoqërisë ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k., z. P.K;
- vi. Aplikimi dhe përfitimi në vitin 2010 i kredisë konsumatore nga subjekti dhe personi i lidhur në “Raiffeisen Bank”, në shumën prej 10,500,000 lekë, pjesë nga fondet e të cilës, shuma 7,800,000 lekë në datë 11.10.2010 është transferuar nga llogaria e personit të lidhur në favor të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me përshkrimin “*pagesë detyrimi*”;
- vii. Mosdeklarimi në deklaratën vjetore të interesave private i qëllimit të marrjes së kësaj kredie dhe destinacionin e vlerave monetare të përfituara prej saj;
- viii. Vënia si kolateral për kredinë e marrë nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, i pasurive në pronësi të z. P.K, apo të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.;
- ix. Mosdeklarimi i burimit të krijimit të shumave të cilat duket se janë depozituar apo transferuar nga z. A.Ç, në llogarinë e bashkëshortes së subjektit për shlyerjen e kredisë (vlera të konsiderueshme), dhe evidentimi i kreditimeve të tjera të kryera nga persona të tretë në këtë llogari – me qëllim shlyerjen e kredisë;
- x. Refuzimi fillestar për deklarimin e pasurive nga shtetasi A.Ç. Mosdeklarimi i burimit të krijimit të kësaj pasurie nga z. A.Ç, si edhe deklarimi i disa rrethanave jo të sakta lidhur me të;
- xi. Regjistrimi në emër të subjektit të rivlerësimit i kontratës për furnizim me ujë të pijshëm për pasuri të ndodhur në objektin e ndërtuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.,

Komisioni ngre dyshime të arsyeshme se kjo pasuri *de facto* është porositur dhe paguar nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur për përdorim, disponimin dhe gëzim të plotë prej tyre, por se kontrata e porosisë *de jure* është lidhur në emër të z. A.Ç, në përpjekje për fshehjen e kësaj pasurie, në dukje me qëllim shmangien e kontrollit dhe verifikimit të ligjshmërisë së burimeve, të cilat kanë shërbyer për pagesën/pagesat e kryer/a për likuidimin e çmimit të blerjes së saj.

**54.1.** Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit për të dhënë argumentet/shpjegimet dhe provat e tij në lidhje me konstatimin e mësipërm, por rezulton se subjekti nuk dërgoi prapësimet e tij, pra nuk paraqiti shpjegime dhe nuk depozitoi prova për të kundërshtuar rezultatet e hetimit.

**54.2.** Nga analiza e rrethanave dhe fakteve të dala nga hetimi, si edhe në vlerësim tërësor të sjelljes së subjektit gjatë hetimit administrativ dhe pas dërgimit të rezultateve të hetimit, trupi gjykues çmon qëndrimin e tij si një përpjekje për të vështirësuar punën e organeve të rivlerësimit, me qëllim pamundësimin e njohjes së të gjithë të vërtetave që lidhen me këtë pasuri.

**54.3.** Sa më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje të pasurisë dhe si rrjedhojë, ai gjendet në kushet e nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.

**54.4.** Gjithashtu, Komisioni vëren se, megjithëse me dërgimin e rezultateve të hetimit subjektit iu kalua barra e provës, ai nuk paraqiti prapësimet e tij, duke mos deklaruar se kur është marrë në dorëzim kjo pasuri, funksionin/destinacionin e saj, si edhe nuk ka depozituar dokumentacionin mbi bazën e të cilit është regjistruar kontrata e UKT-së për pasurinë objekt vlerësimi, kopje të kontratës si edhe librezën ku pasqrohen pagesat e kryera.

**54.5.** Në vijim, nga analiza e dokumentacionit të administruar në dosje lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues çmon se çmimi për blerjen e saj është në vlerën 220,000 euro, sipas kontratës së porosisë të datës 5.8.2009, kjo nisur nga konstatimi i pagesës në shumën prej 30,000 eurosh të kryer në këtë datë, faktit se është pikërisht kjo kontratë, e cila është depozituar në dosjen e kredisë në “Raiffeisen Bank”, si edhe për sa kohë nuk është provuar revokimi i saj.

**54.6.** Referuar parashikimeve të bëra në kontratën e porosisë (paragrafit të fundit të nenit 3), në kushtet kur nuk dokumentohet ndryshimi i afateve të pagesave të kësteve, rezulton se ato duhet të jenë kryer sipas përcaktimeve të bëra në kontratë. Por, nga ana tjetër, referuar shkresës së shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k, dhe informacionit të marrë nga “Raiffeisen Bank”, disa pagesa të kryera nuk përputhen me datat e përcaktuara në kontratë.

**54.7.** Më lart, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë për mundësinë e kryerjes së pagesës së kështit të parë në shumën prej 30,000 eurosh, në datën 5.8.2009. Gjithashtu, Komisioni konstatoi edhe pagesën e kryer në datën 11.10.2010 në shumën 7,800,000 lekë, nga llogaria e personit të lidhur në llogarinë e shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., me burim fondet e përfituara nga kredia bankare në “Raiffeisen Bank”.

**54.8.** Pra, rezulton se dy pagesat e vetme të konstatuara si të kryera në favor të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., dhe për të cilat disponohet dokumentacion provues, janë kryer nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të.

**58.9.** Sa më sipër, nisur nga fakti se nuk ka evidenca të sakta të pagesave të tjera të kryera për likuidimin e çmimit 220,000 euro, rezulton se referuar parashikimeve të bëra në kontratën e porosisë: (i) për vitin 2009 është paguar shuma prej 80,000 eurosh; dhe (ii) për vitin 2010 është paguar shuma prej 120,000 eurosh.

**58.10.** Në këtë kuptim, në kushtet kur Komisioni vlerësi se kjo pasuri është porositur dhe është paguar nga subjekti i rivlerësimit (pasuri e fshehur), si edhe nisur nga parashikimet e bëra në kontratën e porosisë së datës 5.8.2009, me qëllim kryerjen e një hetimi shterues, u krye analiza financiare për të verifikuar mundësinë e subjektit dhe personave të lidhur me të, për kryerjen e pagesave gjatë vitit 2009 dhe 2010, për likuidimin e çmimit të kësaj pasurie, të pasqyruar në tabelat si më poshtë:

**Tabela nr. 8.**

<b>Analiza financiare për periudhën 1.1.2009 – 31.12.2009</b>	<b>Vlerat në lekë</b>
<b>A) Pasuri</b>	<b>30, 263, 939</b>
Njësi tregtare me sip. 124 m <sup>2</sup> , ndodhur në rrugën “****”.	30, 177, 400
Ndryshim likuiditeti	86, 539
<b>B) Detyrime</b>	<b>19, 203, 800</b>
Detyrim i mbetur ndaj shoqërisë “****” sh.p.k.	19, 203, 800
<b>C) Pasuri neto (A-B)</b>	<b>11, 060, 139</b>
<b>D) Të ardhura</b>	<b>2, 043, 951</b>
Të ardhura nga paga, SR	773 326
Të ardhura nga mësimdhënia në universitetin “Kristal”, SR	382 860
Të ardhura nga paga e bashkëshortes	788 146
Të ardhura nga mësimdhënia në universitetin “Kristal” (bashkëshortja)	99 619
<b>E) Shpenzime</b>	<b>2 482 499</b>
Shpenzime jetike	409 860
Shpenzime për kreditë pranë “Tirana Bank” disbursuar në datën 22.8.2005	373 788
Shpenzime për udhëtime jashtë vendit	601 490
Shpenzime shëndetësore jashtë vendit	1 097 360
<b>Balanca e fondeve (D-C-E)</b>	<b>-11 498 687</b>

**Tabela nr. 9.**

<b>Analiza financiare për periudhën 1.1.2010 – 31.12.2010</b>	<b>vlerat në lekë</b>
<b>A) Pasuri</b>	<b>- 765, 486</b>
Ndryshim likuiditeti	- 765, 486
<b>B) Detyrime</b>	<b>10, 500, 000</b>
Kredi tek “Raiffeisen Bank” (Blerje dyqani, te “****” sh.p.k.)	10, 500, 000
<b>C) Pasuri neto (A-B)</b>	<b>- 11, 265, 486</b>
<b>D) Të ardhura</b>	<b>2, 074, 772</b>
Të ardhura nga paga, subjekti i rivlerësimit	817, 877

Të ardhura nga mësimdhënia në universtitetin “Kristal”, subjekti i rivlerësimit	819, 180
Të ardhura nga paga e bashkëshortes	437, 715
<b>E) Shpenzime</b>	<b>19, 585, 382</b>
Shpenzime jetike	409, 860
Shpenzime për kredinë pranë “Tirana Bank”, disbursuar në datën 22.8.2005	325, 093
Shpenzime për kredinë tek “Raiffeisen Bank”, disbursuar në datën 8.10.2010	756, 646
Shpenzime për pagesë pjesë të çmimit ndaj “****” sh.p.k., për blerje dyqani 124 m <sup>2</sup> .	16, 657, 200
Shpenzime për udhëtime jashtë vendit	183, 923
Shpenzime shëndetësore jashtë vendit	832, 860
Shpenzime të deklaruara nga subjekti me Western Union	419, 800
<b>Balanca e fondeve (D-C-E)</b>	<b>-6 245 124</b>

**58.11.** Sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar pagesat e kryera gjatë viteve 2009 dhe 2010, për likuidimin e çmimit për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi.

**58.12.** Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit për të dhënë argumentet shpjegimet dhe provat e tij në lidhje me konstatimin e mësipërm. Por, rezulton se subjekti nuk dërgoi prapësimet e tij, pra, nuk paraqiti shpjegime dhe nuk depozitoi prova për të kundërshtuar rezultatin e hetimit.

**58.13.** Si përfundim, trupi gjykues i qëndron konstatimit dhe rezultatit fillestar se subjekti rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar pagesat e kryera gjatë viteve 2009 dhe 2010, për likuidimin e çmimit për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi, vlerësuar si pasuri e fshehur prej tij, duke u gjendur edhe në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” të ligjit nr. 84/2016.

## **59. Automjeti i deklaruar si i dhuruar nga shtetasi R.H**

**59.1.** Nga verifikimi i deklaratave të interesave private/periodike vjetore të depozituara ndër vite në ILDKPKI, Komisioni konstaton se, në DIP 2011 në seksionin “*ndryshimet e interesave private – pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme*” subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Benz 220, vit prodhimi 2002, dhuratë nga shtetasi R.H”. Ndërsa, në DPV/2013 ka deklaruar të ardhura nga shitja e autoveturës tip “Benz”, shumë prej 4,500 euro.

**59.2.** Në përgjigje të pyetësorit 1, subjekti ka deklaruar<sup>75</sup>: “Dhuratë makine nga shtetasi R.H” (mik i ngushtë), tip benz 220, viti 2011. Shtetasi R.H ka pasur biznes shitblerjen e makinave në Shkodër. Qëllimi i dhurimit, vetëm marrëdhënia miqësore mes tyre dhe për të bërë të mundur lëvizjen e tij sa më lirisht.”

**59.3.** I pyetur nga Komisioni<sup>76</sup> në lidhje me këtë automjet, e konkretisht (i) për marrëdhënien me dhuruesin, nëse ka gjykuar çështje gjyqësore civile/penale, me palë ndërgjyqëse/kallëzues/të kallëzuar/të pandehur/të dëmtuar këtë shtetas; (ii) për burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie nga dhuruesi; si edhe (iii) nëse ka paguar tatim mbi të ardhurat e përfituara në momentin e shitjes së kësaj pasurie në vitin 2013, subjekti

<sup>75</sup> Pjesë nga përgjigjet e pyetjes nr. 4 të pyetësorit nr. 1.

<sup>76</sup> Pyetja nr. 14 e pyetësorit nr. 2.

i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se, *nuk është në dijeni se kur e ka fituar pronësinë pala dhuruese, dhe sot pas kaq vitesh e ka të vështirë ta gjej për shkak të humbjes së kontaktit me këtë shtetas. Gjatë kohës që punonte si gjyqtar në Shkodër ka krijuar marrëdhënie miqësie me të, dhe nuk mban mend që të ketë gjykuar ndonjë çështje që ka lidhje me të apo familjarë të tij...Në kohën që ata ishin miq, ai ushtronte si aktivitet tregtinë e makinave, por nuk di nëse licencën e kishte në emër të tij apo të ndonjë familjari. Nuk i ka interesuar ndonjëherë kjo gjë. Di që nuk ka pasur precedentë penalë në kohën që e ka njohur, dhe vazhdimisht i bënte bisedë për makinat që shiste. Lidhur me shitjen e automjetit në shumën 4,500 euro nuk mban mend në janë shlyer detyrimet tatimore”.*

**59.4.** DPSHTRR-ja<sup>77</sup>, konfirmon se në emër të shtetasit Ken Dhima ka qenë i regjistruar automjeti me targa AA \*\*\* BB, markës “Mercedes – Benz”, tipi 220. Nga verifikimi i dokumentacionit për këtë automjet, rezulton se:

- a) në datën 27.9.2011 ky mjet ka hyrë në territorin, shqiptar, nëpërmjet pikës kufitare të Muriqanit dhe se si pronar i këtij mjeti identifikohet shtetasi R.H<sup>78</sup>;
- b) në datën 28.9.2011 janë kryer procedurat e zhdoganimit të këtij mjeti dhe se referuar deklaratës doganore vlera e e tij është përcaktuar 655,800 lekë dhe janë paguar detyrimet doganore në shumën 131,160 lekë. Pra, rezulton se vlera e këtij mjeti pas zhdoganimit është në shumën 786,960 lekë.
- c) në datën 30.9.2011 (vetëm 1 ditë mbas zhdoganimit) ky automjet mjet i është dhuruar<sup>79</sup> subjekti të rivlerësimit. Si palë dhuruese në kontratë shfaqet shtetasi A.P, përfaqësuar me prokurë të posaçme nga shtetasi R.Y.H.

**59.5.** Pavarësisht se nga dokumentacioni i administruar rezulton se dhurues është shtetasi A.P, subjekti në të gjitha deklaratimet e tij, ka identifikuar si dhurues të këtij automjeti shtetasin R.H.

**59.6.** Sa më sipër, Komisioni vlerëson se në referim të pikës 14 të nenit 3 si dhe pikës 4 të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, shtetasi R.H bën pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, në këtë rast bazuar në parimin e proporcionalitetit të provojë ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të cilat kanë shërbyer për blerjen e këtij automjeti dhe pagesat e kryera për zhdoganimit e tij.

**59.7.** Komisioni konstaton se gjatë hetimit administrative, por edhe pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar dokumentacion ligjor provues për të ardhurat e personit tjetër të lidhur, shtetasit R.H, të cilat pretendohen se kanë mundësuar blerjen e pasurisë objekt vlerësimi.

**59.8.** Si rrjedhojë, trupi gjykues arrin në konkluzionin se duke mos provuar me dokumentacion ligjor burimin e të ardhurave të dhuruesit – të cilat pretendohet se kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie, gjendet në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, germa “b”, e ligjit 84/2016.

**59.9.** Në vijim të hetimeve, pas kërkesës së bërë nga Komisioni<sup>80</sup>, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër<sup>81</sup> informon se, subjekti i rivlerësimit z. Ken Dhima, ka gjykuar çështjen penale me të pandehur shtetasin R.Y.H (deklaruar nga subjekti si dhuruesi i pasurisë objekt vlerësimi).

**59.10.** Rezulton se, subjekti i rivlerësimit, z. Ken Dhima, në cilësinë e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ka gjykuar çështjen me të pandehur shtetasin R.H, akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor” parashikuar nga neni 290/1, i Kodit Penal, çështje për të cilën ka disponuar me vendimin nr. \*\*\*, datë 27.3.2008.

<sup>77</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 26.3.2020.

<sup>78</sup> Dokument hyrje leje qarkullimi provizor nr. \*\*\* prot., nr serie \*\*\*, datë 29.9.2011, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit, Shkodër.

<sup>79</sup> Kontratë dhurim automjeti nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 30.9.2011

<sup>80</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 27.5.2021.

<sup>81</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 1.6.2021.

**59.11.** Në vlerësim të rrethanave dhe fakteve të mësipërme, trupi gjykues çmon se kjo dhuratë i është bërë subjektit të rivlerësimit për shkak të pozicionit të tij, dhe në këtë kuptim ai ka vepruar në kundërshtim me rregullat e etikës dhe në kushtet e konfliktit të interesit sipas parashikimit të bërë në pikën 1 të nenit 23 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve”, i ndryshuar.

**59.12.** Si konkluzion, trupi gjykues vlerëson se në këtë rast subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “d” të ligjit nr. 84/2016, çka përbën shkak për cenimin e besimit të publikut, në kuptim të pikës 5 të nenit 61 të këtij ligji.

## **60. Dhurime, hua, sponsorizime/ndihma financiare, shpërblime, etj., të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit ndër vite**

**60.1.** Nga verifikimi i deklaratave të interesave private/periodike vjetore të depozituara ndër vite nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI si edhe i deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting”, krahas dhurimeve dhe huave të trajtuara më lart, u konstatuan deklaratime të bëra për hua, dhurime, sponsorizime, ndihma financiare, si edhe të ardhura nga shitja e librave, të pasqyruara si më poshtë:

### **Dhuratë në shumën 400,000 lekë, nga Sh dhe M.Ç**

**60.2.** Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar, të ardhura nga dhurimi i bërë në vitin 2007 (për mobilim shtëpie), nga Sh e M.Ç në vlerën 400,000 lekë, që provohet me deklaratën noteriale të rikonfirmimit me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 19.10.2012. Gjithashtu, rezulton se në DPV/ 2007 subjekti ka deklaruar dhuratë në të holla nga vjehri dhe vjehrra Sh.Ç dhe M.Ç, shumën 400,000 lekë. Referuar deklaratës noteriale<sup>82</sup> të datës 19.10.2012, shtetasit Sh dhe M.Ç, deklarojnë se i kanë dhuruar vajzës së tyre K.Ç në vitin 2007, një shumë prej 400,000 lekësh.

### **Hua në shumën 10,000 euro nga shtetasi E.Z**

**60.3.** Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar si detyrim financiar, shumën 3,000 euro, detyrim i rrjedhur nga huaja e marrë shtetasit E.Z. Detyrimi i krijuar në vitin 2012, pa afat dhe pa interes dhe jo nëpërmjet sistemit bankar. Qëllimi i huas ka qenë likuidimi i parakohshëm i një pjese të kredisë të marë nga “Tirana Bank”.

**60.4.** Në DPV/2012, subjekti dhe personi i lidhur kanë deklaruar detyrim financiar në shumën 10,000 euro nga kontrata e huas me shtetasin E.Z, datë 10.1.2012, dhe se kanë shlyer në datën 20.12.2012 shumën prej 7,000 euro, me burim kursimet. Detyrimi i mbetur shuma prej 3,000 euro.

**60.5.** Referuar deklaratës së datës 10.1.2012 (shkresë e thjeshtë), subjekti i rivlerësimit deklaroi se i ka marrë borxh shtetasi E.Z shumën prej 10,000 euro, pa interes dhe pa afat të caktuar shlyerje. Ndërsa me deklaratën e datës 20.12.2012 (shkresë e thjeshtë), subjekti deklaroi se i ka shlyer në datën e deklarimit huadhënësit E.Z, shumën prej 7,000 euro, dhe se pjesa tjetër e detyrimit do të shlyhet në një afat të pacaktuar. Të dyja deklaratat duket se janë nëshkruar edhe prej huadhënësit, z. E.Z<sup>83</sup>.

**60.6.** Gjithashtu, me anë të deklaratës noteriale<sup>84</sup> të datës 29.10.2016, shtetasi E.Z deklaroi se në datën 10.1.2012 i ka dhënë hua pa interes shtetasit Ken Dhima, shumën prej 10,000 euro. Nga kjo shumë brenda vitit i është likuiduar shuma prej 7,000 euro.

<sup>82</sup> Deklarata noteriale nr. \*\*\* rep., \*\*\* kol., datë 19.10.2012, ndodhur Aneks \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>83</sup> Deklarata të depozituara nga subjekti në mbështetje të deklaratës vetting, ndodhur Aneks \*\*\* në dosjen e ILDKPKI.

<sup>84</sup> Deklarata noteriale nr. \*\*\* rep., nr \*\*\* kol., datë 29.10.2016, ndodhur Aneks \*\*\* në dosjen e ILDKPKI.

## **Hua në shumën 6,000 euro nga shtetasi V.Dh**

**60.7.** Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar detyrim financiar në shumën 6,000 euro, hua e marrë prej babait në fillim të muajit janar të vitit 2012. Huaja është pa afat dhe pa interes. Qëllimi i huas ka qenë likuidimi i parakohshëm i një pjese të kredisë së mbetur pa shlyer nga “Tirana Bank”. Rezulton se kjo hua (borxh) është deklaruar në DPV/2012 nga subjekti i rivlerësimit. Referuar deklaratës noteriale<sup>85</sup> të dates 18.1.2017, z. V.Dh, ka deklaruar se i ka dhënë subjektit të rivlerësimit në vitin 2012 hua pa interes, shumën prej 6,000 euro, për një afat të pacaktuar kohor.

## **Sponsorizime, shpërblime dhe dhurime nga A.M në shumën 64,300 euro**

**60.8.** Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar: *Sponsorizim nga shtetasi A.M për vitet 2008 - 2013. Këto sponsorizime dhe dhurata janë bërë nga ish presidenti i kompanisë “\*\*\*” sh.p.k., dhe janë bërë kryesisht për punën e tij si pedagog pranë universitetit Kristal për shumë vjet, për kurimin e bashkëshortes K.Ç jashtë shtetit, si dhe për pushime jashtë vendit sëbashku me familjen e tij. Këto pagesa nuk janë bërë nëpërmjet sistemit bankar apo nga arka e kompanisë. Kjo provohet nga vetë shtetasi si dhe nga dy deklaratat noteriale të cilat konfirmojnë faktet e parashikuara më sipër.*

**60.9.** Ndërsa nga verifikimi i deklaratave të interesave privatë/periodikë vjetorë të depozitura nga subjekti i rivlerësimit ndër vite në ILDKPKI, konstatohet:

- i. Në DPV/2008, subjekti ka deklaruar sponsorizime nga A.M, president i kompanisë “\*\*\*” (mik i familjes) për: (i) sponsorizim për pushime në Turqi dhe Egjipt, shuma 3,800 euro; (ii) sponsorizim për botim libri, shuma 20,000 euro;
- ii. Në DPV/2009, subjekti ka deklaruar sponsorizime nga A.M për: (i) sponsorizim për udhëtim turistik, shuma 2,500 euro; (ii) sponsorizim për operacionin e bërë jashtë shtetit, shuma 8,000 euro;
- iii. Në DPV/2010 subjekti ka deklaruar, dhuratë nga A.M shumën prej 10,000 euro;
- iv. Në DPV/2011 subjekti ka deklaruar, dhuratë në të holla nga shtetasi A.M, shumën 15,000 euro.
- v. Në DPV/2013 subjekti ka deklaruar, shpërblim nga puna si pedagog prej universitetit “Kristal”, shumën 5,000 euro.
- vi. Referuar dokumentit<sup>86</sup> me titull “Kontratë dhurimi”, datë 15.01.2008, shtetasi A.M, presidenti i universitetit “Kristal”, ka deklaruar se i dhuron pedagogut të këtij universiteti, z. Ken Dhima, shumën 20,000 euro.
- vii. Me anë të deklaratës noteriale<sup>87</sup> të datës 25.10.2016, shtetasi A.M ka deklaruar se nga të ardhurat e fituara si rezultat i veprimtarisë tregtare të universitetit “Kristal”, në datë 15.1.2008 i ka dhënë në formë shpërblimi/sponsorizimi shumën 20,000 euro, ka sponsorizuar për kurimin e bashkëshortes në Austri dhe gjithashtu shpenzimet e udhëtimeve familjare në vitin 2008 në shumën 3,800 euro, për udhëtimin në Turqi.
- viii. Me anë të deklaratës noteriale<sup>88</sup> të datës 22.1.2017, shtetasi A.M ka deklaruar se i ka dhënë subjektit të rivlerësimit dhurime për shpërblime dhe sponsorizime për periudhën 2010 - 2013 në shumat 10,000 euro, 15,000 euro dhe 5,000 euro, të cilat nuk janë paguar nga arka e kompanisë, por nga të ardhurat e tij monetare personale.

<sup>85</sup> Deklarata noteriale nr \*\*\* rep., nr \*\*\* kol., datë 18.1.2017, ndodhur Aneks \*\*\* në dosjen e ILDKPKI.

<sup>86</sup> Kontratë dhurimi (shkresë e thjeshtë) datë 15.01.2008, ndodhur Aneks \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>87</sup> Deklarata nr. \*\*\* rep., nr \*\*\* kol., datë 25.10.2016, ndodhur Aneks \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>88</sup> Deklarata nr. \*\*\* rep., nr. 104/2 kol., datë 22.1.2017, ndodhur Aneks \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.



- ix. Referuar deklaratës<sup>89</sup> së datës 30.4.2014, shtetasi A.M ka konfirmuar (pa dhënë vlera në shifra), se ka sponsorizuar tri udhëtime në Turqi dhe për përgatitjen e librave të ndryshëm, por nuk i ka përballuar këto shpenzime nga llogaria e kompanisë, por nga shpenzimet e veta.

### **Sponsorizim në shumën 150,000 lekë nga shtetasi Xh.H**

**60.10.** Rezulton se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vettinv bg”, subjekti ka deklaruar sponsorizim për botim libri nga shtetasi Xh.H, në vlerën 150,000 lekë, provuar me deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 24.10.2016.

**60.11.** Komisioni konstaton se në DPV/2005 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar sponsorizim për botim libri, shumën 150,000 lekë, por nuk ka deklaruar individin/subjektin sponsorizues.

**60.12.** Ndërsa, në përgjigje të pyetësorit nr. 1<sup>90</sup>, subjekti i rivlerësimit ka specifikuar se sponsorizimi ka shërbyer për botimin e librit “*Fjalori i termave të së drejtës italisht – shqip – italisht*”, provuar me deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 24.10.2016, dhe se përse i përket burimit të krijimit të kësaj shumë, deklaroi se shtetasi Xh.H ka qenë biznesmen në Gjirokastër.

**60.13.** Referuar deklaratës noteriale të datës 24.10.2016 (të sipërcituar) rezulton se shtetasi Xh.H ka deklaruar se *në vitin 2004 i ka dhënë në formën e sponsorizimit shtetasit D.A me detyrë aktuale gjyqtar, shumën 150,000 lekë, për botimin e librit “Fjalor italisht-shqip-italisht”.*

**60.14.** Komisioni vëren se ka mospërputhje në deklaratimet e subjektit, pasi në referim të deklaratës noteriale konstatohet se: (1) sponsorizimi në shumën 150,000 lekë është kryer në favor të shtetasit D.A (i cili duket se është bashkautor i librit); dhe se (2) kjo shumë është sponsorizuar në vitin 2004 dhe jo në vitin 2005 kur rezulton se është deklaruar për herë të parë nga subjekti.

**60.15.** Sa më sipër, në referim të pikës 14 të nenit 3, si dhe pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, shtetasit M.Ç, E.Z, V.Dh, A.M, dhe Xh.H bëjnë pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, në këtë rast të provojnë ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të cilat kanë shërbyer për krijimin e shumave të pretenduara si të dhëna hua, dhuruara, apo të dhëna në formë shpërblimesh, ndihmë financiare apo sponsorizim në favor të subjektit të rivlerësimit.

**60.16.** Komisioni vëren se gjatë hetimit administrativ subjekti ka deklaruar mbi burimin e krijimit të të ardhurave të personave të tjerë të lidhur, por nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor në mbështetje të deklaratimeve të tij.

**60.17.** Me dërgimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 subjektit iu kalua barra e provës për të depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e personave të tjerë të lidhur, të cilat pretendohen se kanë shërbyer si burim krijimi për dhurimet, huat, shpërblimet, sponsorizimet apo ndihmat financiare, të konstatuara si më sipër.

**60.18.** Në kushtet kur subjekti nuk paraqiti prapësimet e tij lidhur me rezultatet e hetimit administrativ, duke mos provuar me dokumentacion justifikues ligjor të ardhurat e personave të tjerë të lidhur, sipas parashikimit të bërë në nenin 32/4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues arrin në konkluzionin se këto vlera monetare të deklaruara si dhurime, hua, shpërblime, sponsorizime apo ndihma financiare, të mos reflektohen në analizën financiare dhe si rrjedhojë, ato nuk mund të kenë shërbyer si burim për krijimin e pasurive apo mbulimin e shpenzimeve.

---

<sup>89</sup> Deklaratë e thjeshtë drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, ndodhur në aneks \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>90</sup> Përgjigjet e pyetjes nr. 4.

## **Të ardhura të deklaruara nga shitja e librave**

**61.** Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore të depozituara ndër vite nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI rezulton se subjekti ka deklaruar të ardhura nga shitja e librave, për vitet dhe shumat si vijon: (i) për vitin 2005 shumën 100,000 lekë; (ii) për vitin 2007 shumën 910,000 lekë; (iii) për vitin 2008 shumën 750,000 lekë; (iv) për vitin 2009 shumën 800,000 lekë; (v) për vitin 2010 shumën 300,000 lekë; (vi) për vitin 2011 shumën 200,000 lekë; dhe (vi) për vitin 2012 shumën 300,000 lekë. Në total, për vitet 2005 – 2013 ka deklaruar si të ardhura të përfituara nga shitja e librave shumën 3,360,000 lekë.

**61.1.** Komisioni konstaton se, subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të provuar përfitimin e këtyre të ardhurave të deklaruara ndër vite dhe pagesën e detyrimeve tatimore lidhur me to, në përputhje me pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

**61.2.** Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se këto të ardhura të pretenduara nuk mund të kenë shërbyer si burim për krijimin e pasurive apo mbulimin e shpenzimeve të subjektit dhe personave të lidhur me të dhe, si rrjedhojë, nuk janë përfshirë në analizën financiare.

## **LLogaria bankare dyemërore (M.Ç dhe K.Dh – vajza e subjektit)**

**62.** Në deklaratën periodike të vitit 2013 subjekti ka deklaruar një depozitë në BKT nga vjehrra M.Ç e cila figuron në depozitë bashkë me vajzën e tij K.Dh, pa dijeninë e prindërve qysh në vitin 2008. Subjekti ka ardhur në dijeni të këtij fakti në datën 24.03.2014, dhe se shuma në llogari ishte 7,046 euro. Nga hetimi kanë rezultuar disa lëvizje në këtë llogari si depozitime dhe më vonë shuma është tërhequr në mars dhe maj të vitit 2014. Komisioni konstaton se, në kundërshtim me kërkesat e nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit nuk deklaroi dhe nuk depozitoi dokumentacion justifikues ligjor për burimin e të ardhurave të personit tjetër të lidhur, znj. M.Ç, të cilat kanë shërbyer për krijimin e llogarisë së kursimit të përbashkët, me personin e lidhur.

**62.1.** Si përfundim, trupi gjykues arrin në përfundimin se nuk provohet ligjshmëria e burimeve financiare, të cilat kanë shërbyer për krijimin e fondeve në llogarinë bankare dyemërore të konstatuar më sipër.

## **Automjete të deklaruara në përdorim**

**63.** Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *“Në bazë të kontratës së huapërdorjes me nr. \*\*\* rep \*\*\* datë 27.7.2015 rezulton se, ka pasur dhe ka në huapërdorje mjetin tip Audi, në pronësi të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., si dhe një mjet tjetër Audi me targë AA\*\*\*KG, në pronësi të shtetasit A.D, kjo provohet me kontratën me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 20.06.2018”.*

**63.1.** Pas kërkesës së bërë nga Komisioni<sup>91</sup>, u administruan aktet nga noteri S.M<sup>92</sup>, në të cilat subjekti i rivlerësimit identifikohet si palë. Gjithashtu nga hetimi i dokumentacionit të DPSHTRR-së rezultoi se këto mjete janë blerë fillimisht nga shtetasi A.D dhe vlera e tyre në total pas zhdoganimit është rreth 45,000 euro.

**63.2.** Në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, pikat 11 dhe 19 të nenit 3 dhe nenin 32 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si edhe nenin 4 të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklarojë në deklaratën “Vetting” këto pasuri/përdorimin e tyre, si edhe të paraqiste dokumentacionin justifikues ligjor lidhur me burimin e krijimit të tyre.

<sup>91</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 27.5.2021.

<sup>92</sup> Shkresa e protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 10.6.2021.

**63.3.** Referuar pikës 11 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, pasuri janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit. Bazuar në germen “b” të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, subjekti ka detyrimin të deklarojë pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë dhe të drejtat reale mbi to sipas Kodit Civil.

**63.4.** Referuar pikës 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojnë ligjërisht ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur. Ndërsa në pikën 3 të këtij neni parashikohet se subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave.

**63.5.** Në pikën 1 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 parashikohet se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

**63.6.** Sa më sipër, konstatohet se subjekti i rivlerësimit në kundërshtim me kërkesat e ligjit nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” përdorimin e këtyre dy automjeteve. Në këtë kontekst, trupi gjykues e vlerëson këtë situatë si përpjekje për shmangien e hetimit administrativ për këto pasuri, si edhe verifikimit të mundësisë së konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit me individin apo shoqërinë të cilët i kanë lënë në përdorim.

**63.7.** Në vlerësim të rrethanave dhe fakteve konstatuara nga hetimi i kryer si: (i) mosdeklarimi i përdorimit të këtyre automjeteve në deklaratën “Vetting”; (ii) përdorimi të këtyre automjeteve pa kundërshtim prej korrikut të vitit 2015 e në vijim; (iii) si edhe nisur nga vlera e konsiderueshme të tyre, trupi gjykues ngre dyshime të arsyeshme mbi bazën e *indicieve* të besueshme se kemi të bëjmë pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit.

**63.8.** Në vijim të hetimeve, pas kërkesës së bërë nga Komisioni<sup>93</sup>, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë<sup>94</sup> informon se gjatë vitit 2016, subjekti i rivlerësimit z. Ken Dhima, ka gjykuar çështjen palë paditëse shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., me përfaqësues ligjor z. A.D, me palë të paditur ISSH Tiranë, me objekt “shfuqizim tërësisht të aktit administrativ...”, ndërkohë që në korrik të vitit 2015 kishte marrë në përdorim të tij 2 automjete: njëri në pronësi të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., dhe tjetri në pronësi të shtetasit A.D.

**63.9.** Sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka qenë në kushtet e parashikuara në nenin 72, pika 6 të Kodit të Procedurës Civile dhe se ka pasur detyrimin për të hequr dorë nga gjykimi i kësaj çështje, pasi konstatohet gjendje konflikti ndërmjet detyrës dhe interesave privatë të tij.

**63.10.** Si rrjedhojë, trupi gjykues çmon subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kundërshtim me rregullat e etikës, duke e vendosur veten në kushtet e cenimit të paanësisë, në lidhje me kujdesin e tij ndaj konfliktit të interesit, në kuptim të nenit 75, pika 4 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si edhe në kundërshtim me parashikimet e bërë në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve”, i ndryshuar.

**63.11.** Në vijim të arsyetimit, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “d” të ligjit nr. 84/2016, çka përbën shkak për cenimin e besimit të publikut, në kuptim të pikës 5 të nenit 61 të këtij ligji.

<sup>93</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 27.5.2021.

<sup>94</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 1.6.2021.

## **Apartamenti në Golem**

**64.** Konstatohet se në DPV/2018 subjekti ka deklaruar pasurinë e llojit “apartament banimi” me sipërfaqe 92 m<sup>2</sup>, ndodhur në Golem, Kavajë, ende e paregjistruar, në emrin e tij dhe të bashkëshortes K.Ç, fituar me testament nga babai i bashkëshortes, z. Sh.Ç, kjo e provuar me vendimin për lëshimin e dëshmisë testamentare nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 3.3.2018. Vlera e papërcaktuar për shkak se është fituar me testament. Ka deklaruar se zotëron 25 % pjesë takuese mbi këtë pasuri.

**64.1.** Gjithashtu, Komisioni konstaton se në përgjigje të pyetësorit 1, lidhur me burimin e krijimit ka deklaruar të ardhura nga emigracioni të vjehrrit dhe kunetërve, shitjen me shumicë te tregu i \*\*\*, të ardhura nga bar-restoranti në \*\*\* Pogradec dhe nga veprimtaria e palicencuar e vjehrrit të këmbimit valuator.

**64.2.** Me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit, duke i kërkuar subjektit të depozitojë dokumentacion justifikues ligjor për të provuar mënyrën e fitimit të kësaj pasurie, si edhe për burimin e të ardhurave të shtetasit Sh.Ç, të cilat kanë shërbyer për krijimin e saj, por, Komisioni vëren se, edhe në këtë rast, subjekti nuk është treguar bashkëpunues, pasi nuk ka dhënë shpjegime dhe nuk ka depozituar dokumentacionin e kërkuar.

**64.3.** Në këtë kontekst, vlen të theksohet fakti se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë bashkëpunues gjatë procesit të rivlerësimit të kryer ndaj tij, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016 dhe si rrjedhojë, ky qëndrim i tij, sjella dhe mungesa e gatishmërisë janë faktorë që janë mbajtur në konsideratë nga ky trup gjykues në marrjen e vendimit.

## **Analiza Financiare për vitet 2003 – 2017**

**65.** Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, deklaramet e subjektit të rivlerësimit në ILDKPKI si edhe në përgjigje të pyetësorëve të dërguar gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioni kreu **analizën e treguesve financiarë** lidhur me pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur, për çdo vit, për periudhën 2003 – 2017, nga ku rezulton se vitet 2004, 2005, 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2014, 2015, 2016, dhe 2017 paraqiten me balancë negative të fondeve, e konkretisht:

1. për vitin 2004 – balanca negative e fondeve (- 364,216 lekë);
2. për vitin 2005 – balanca negative e fondeve (- 1,177,952 lekë);
3. për vitin 2007 – balanca negative e fondeve (- 1,825,753 lekë);
4. për vitin 2008 – balanca negative e fondeve (- 1,291,532 lekë);
5. për vitin 2009 – balanca negative e fondeve (- 11,498,687 lekë);
6. për vitin 2010 – balanca negative e fondeve (- 6,245,124 lekë);
7. për vitin 2011 – balanca negative e fondeve (- 7,911,770 lekë);
8. për vitin 2012 – balanca negative e fondeve (- 5,549,290 lekë);
9. për vitin 2014 – balanca negative e fondeve (- 1,014,661 lekë);
10. për vitin 2015 – balanca negative e fondeve (- 15,372,748 lekë);
11. për vitin 2016 – balanca negative e fondeve (- 3,520,498 lekë);
12. për vitin 2017 – balanca negative e fondeve (- 4,751,233 lekë).

**65.1.** Pas kalimit të barrës së provës, Komisioni vëren se subjekti nuk depozitoi shpjegime apo prova për të kundërshtuar rezultatet e analizës financiare.

**65.2.** Sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurive, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të deklaruara dhe të konstatuara për vitet 2004, 2005, 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2014, 2015, 2016 dhe 2017, duke u gjendur kushtet e nenit 33, pika 5, germa

“b” të ligjit nr. 84/2016. Totali i balancës negative për periudhën vitet 2003 – 2017, është në shumën 60,523,462 lekë<sup>95</sup>.

### **Konkluzioni për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe vlerësimi tërësor i çështjes**

**66.** Mbështetur në rrethanat e faktit dhe të dhënat e mbledhura gjatë hetimeve, si dhe provat shkresore të administruara në dosje, lidhur me kriterin e vlerësimit pasuror, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit: 1) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; 2) ka kryer fshehje të pasurisë; 3) ka kryer deklaram të rremë; si edhe 4) është gjendur në situatën e konfliktit të interesit, duke u vendosur në kushtet parashikuara në nenin 33, pika 5, geramat “b”, “c”, “ç” dhe “d” të ligjit nr. 84/2016.

**66.1.** Komisioni, bazuar në konkluzionet e mësipërme, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

**66.2.** Gjithashtu, në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pasi Komisioni vlerësoi në tërësi të gjitha konstatimet që lidhen me vlerësimin e pasurisë, arriti në përfundimin se ato janë të tilla që e çojnë këtë trup gjykues në konkluzionin se subjekti me veprimtarinë e tij ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë në një mënyrë të pariparueshme nëpërmjet programeve të trajnimit të Shkollës së Magjistraturës.

**66.3.** Sa më sipër, vlerësohet gjithashtu se vazhdimi i ushtrimit prej tij të funksioneve të gjyqtarit do të ishte i papërshtatshëm dhe në kundërshtim me parashikimet e nenit 179/b, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, duke u gjendur në kushtet nenit 61/5 të ligjit nr. 84/2016.

### **V. KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE**

**67.** Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, arrin në përfundimin se:

1. subjekti nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
2. subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë;
3. subjekti nuk u tregua bashkëpunues gjatë procesit të hetimit administrativ të kryer ndaj tij.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 2 të nenit 4, si edhe pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar nenit 48, nenit 58, pika 1, germa “c”, si dhe nenit 61, pika 3 dhe pika 5 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

<sup>95</sup> Referohu tabelës përmbledhëse të analizës financiare, Aneks 1 – pjesë e këtij vendimi.

## **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Ken Dhima, me detyrë gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.
  2. Vendimi i arsyetuar u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik, vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
  3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij.
  4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
- U shpall në Tiranë, më 29.7.2021.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Brunilda BEKTESHI**  
**Kryesuese**

**Suela ZHEGU**  
**Anëtare**

**Pamela QIRKO**  
**Relatore**

*Sekretare gjyqësore*  
*Ertugena Sokoli/ Amela Idrizi*

## ANEKS 1 – TABELA PËRMBLEDHËSE E ANALIZËS FINANCIARE

	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
<b>A) PASURI</b>	<b>62,835</b>	<b>1,433,139</b>	<b>8,437,111</b>	<b>272,413</b>	<b>560,821</b>	<b>460,558</b>	<b>30,263,939</b>	<b>-765,486</b>	<b>8,023,222</b>	<b>21,094,007</b>	<b>222,145</b>	<b>1,749,836</b>	<b>51,811,470</b>	<b>-1,421,614</b>	<b>-1,623,028</b>
Apartament me sip. 114.6 m2, ndodhur në Rr. "****", Hyrja ****, Ap. **** (referuar certifikatës për vërtetim pronësie të datës 14.4.2015). Viti i krijimit 2005. Vlera 74.000 Euro. Pjesa që zotëron ½.			9,142,080												
Njësi tregtare me sip. 124 m2, ndodhur në rrugën ***; vlera 150,000 euro. Datë 10.08.2009.							30,177,400								
Apartament me sip. 109 m2, ndodhur në Shëngjin Lezhë Vlera 60,000 Euro. Dt 03.02.2011 ***.									6,915,000						
Njësi shërbimi me sipërfaqe 44m2 dhuruar nga vëhri dhe vëhrra Sh dhe M.Ç dt 19.10.2012										21,000,000					
Pasuri e tipit Garazhd *** me sip. 18.9 m2 dhe *** me sip. 18.2 m2, ndodhur në adresë Rr. "*****" Tiranë, blerë nga shoqëria "*****" shpk. Vlera 4.500 Euro, viti i krijimit 2015. Pjesa që zotëron ½.													1,262,520		
Njësi shërbimi me sip. 46 m2, ndodhur në Rr. "*****" Tiranë, sipas certifikatës për vërtetim pronësie lëshuar me datë 20.8.2016. Viti i krijimit 2015. Vlera e pronës pas rivlerësimit 21.000.000 lekë. Pjesa që zotëron ½													7,500,000		
Njësi shërbimi nr 16 me sip. 47 m2, e ndodhur në Rr. "*****", e vërtetuar me kontratën e prenotimit me nr. ****, dt. 16.7.2015, e lidhur midis sipërmarrësit, shoqëria "*****" shpk dhe porositës Ken Dhima e K.Ç.													7,500,000		
Njësi shërbimi nr *** me sip 47.23m2; Njësi shërbimi nr*** me sip 42.62m2; Njësi shërbimi nr *** me sip 98.33m2; total sipërfaqja e 3 njësisve 188.18 m2, ndodhur në Rr. "*****" me nr. ****, dt.													33,920,952		
Ambjent banimi me sip. 51.65 m2, e ndodhur në L. ****, Ap. ****.															
Pasuri në proces legalizimi, ku deklarues është babai im V.Dh, provuar me vetëdeklarimin datë 10.11.2006. ku															
Automjet BENZ 250 (blerë në datën 22.01.2005) Targa **** (***) (***)			700,000												
Automjet BENZ 220 vit prodhimi 2002(dhuruar nga A.G.P prokur R.H 30.09.2011) Targa **** (***)									786,960						
Ndryshim likuiditeti	62,835	1,433,139	-1,404,969	272,413	560,821	460,558	86,539	-765,486	321,262	94,007	222,145	1,749,836	1,627,998	-1,421,614	-1,623,028
TOTAL LIKUIDITETE	62,835	1,495,974	91,005	363,418	924,239	1,384,797	1,471,336	705,849	1,027,112	1,121,119	1,343,263	3,093,100	4,721,098	3,299,484	1,676,456
<b>B) DETYRIME</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>6,249,540</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>19,203,800</b>	<b>10,500,000</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>41,038,452</b>	<b>21,000,000</b>	<b>0</b>
Kredi për blerje shtëpie Tirana Bank			6,249,540												
Hua të mara ndaj palëve të treta Sh.Ç dhe M.Ç														14,000,000	
Kredi tek Raiffeisen Bank (Blerje dyqani *** Shpk)								10,500,000							
Kredi tek OTP BANK (Ish Societe Generale)														21,000,000	
Detyrim I mbetur ndaj shoqërisë *** Shpk.													27,038,452		
Detyrim I mbetur ndaj shoqërisë *** Shpk.							19,203,800								
<b>C) PASURI NETO (A-B)</b>	<b>62,835</b>	<b>1,433,139</b>	<b>2,187,571</b>	<b>272,413</b>	<b>560,821</b>	<b>460,558</b>	<b>11,060,139</b>	<b>-11,265,486</b>	<b>8,023,222</b>	<b>21,094,007</b>	<b>222,145</b>	<b>1,749,836</b>	<b>10,773,018</b>	<b>-22,421,614</b>	<b>-1,623,028</b>
<b>D) TË ARDHURA</b>	<b>708,936</b>	<b>1,426,559</b>	<b>1,647,458</b>	<b>1,621,537</b>	<b>1,773,300</b>	<b>2,426,126</b>	<b>2,043,951</b>	<b>2,074,772</b>	<b>2,698,844</b>	<b>22,831,914</b>	<b>2,097,835</b>	<b>3,862,285</b>	<b>3,336,141</b>	<b>4,656,906</b>	<b>3,189,217</b>
Të ardhura nga paga SR	357,016	778,600	789,078	806,676	836,309	822,412	773,326	817,877	1,003,944	946,567	882,418	1,038,248	1,090,889	1,071,401	1,098,302
Të ardhura nga mësimdhënia në Universitetin Kristal SR						641,040	382,860	819,180	858,211	27,150	556,027				
Të ardhura nga mësimdhënia në Universitetin Sevasti dhe Parashqevi Qirjazi SR									2,250						
Të ardhura nga paga e bashkëshortes	351,920	574,822	831,911	814,861	829,691	786,926	788,146	437,715	834,439	858,197	659,390	811,820	1,072,252	1,078,005	1,128,290
Të ardhura nga ISSH bashkëshortes												392,217			
Të ardhura nga mësimdhënia në Universitetin Kristal (Bashkëshortja)					107,300	175,748	99,619								
Dhurata në formë njësi tregtare nga vëhri dhe vëhrra (Shi dhe M.Ç)										21,000,000					
Të ardhura nga qiraja e lokalit rr ***												1,620,000	1,173,000	1,759,500	146,625
Të ardhura nga qiraja e ambientit për Postën Shqiptare Rr ***														748,000	816,000
Të ardhurat nga interesat depozita me afat Tirana Bank		73,137	26,469												
<b>E) SHPENZIME</b>	<b>281,592</b>	<b>357,636</b>	<b>637,839</b>	<b>1,095,382</b>	<b>3,038,232</b>	<b>3,257,100</b>	<b>2,482,499</b>	<b>19,585,382</b>	<b>2,587,391</b>	<b>7,287,197</b>	<b>1,678,665</b>	<b>3,127,109</b>	<b>7,935,871</b>	<b>30,599,017</b>	<b>9,563,478</b>
Shpenzime jetike	281,592	281,592	328,671	328,671	707,904	409,860	409,860	409,860	409,860	423,072	521,789	879,992	897,104	940,368	846,331
Shpenzime për kredinë pranë Tirana Bank disbursuar datë 22.08.2005			301,203	742,589	1,930,328	2,379,147	373,788	325,093	380,187	2,437,835					
Shpenzime për kredinë tek Raiffeisen Bank disbursuar datw 08.10.2010								756,646	1,538,032	3,618,010	1,126,030	2,186,870	5,903,391		
Shpenzime për kredinë tek OTP Bank disbursuar datw 18.05.2016														1,155,000	2,507,000
Shpenzime për pagesë pjesw tv çmimit ndaj *** Shpk për blerje dyqani 124 m2.								16,657,200							
Shpenzime për pagesë pjesw tv çmimit ndaj *** Shpk për blerje dyqanesh me nr ****/****/**** (188.18 m2).														13,527,000	5,534,576
Shpenzime për udhëtime jashtë vendit		76,044	7,965	24,122	0	468,094	601,490	183,923	259,313	389,120	30,846	60,247	258,094	476,150	675,571
Shpenzime shëndetësore jashtë vendit							1,097,360	832,860		419,160					
Shpenzime të deklaruara nga subjekti me çestern Union								419,800							
Shpenzime për shlyerje huaje ndaj palëve të treta Sh dhe M.Ç (03.06.2016)														14,000,000	
Shpenzime për arsimin e vajzës													877,282	500,499	
Shpenzime mobilimi apartmaneti në rrugën ***.					400,000										
Analiza Financiare (D-C-E)	364,509	-364,216	-1,177,952	253,741	-1,825,753	-1,291,532	-11,498,687	-6,245,124	-7,911,770	-5,549,290	197,025	-1,014,661	-15,372,748	-3,520,498	-4,751,233